



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE MBETURINA
REGULATORNI URED ZA VODOVOD I OTPAD
WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE



Zyra Rregullatore për Ujësjiellës dhe Mbeturina

Shërbimet e Furnizimit me Ujë dhe Ujëra të Zeza

UDHËZIMET E KONTABILITETIT RREGULLATOR

Verzioni 2

Qershor 2011

PROGRAMI I KONTROLLIMIT TË NDRYSHIMEVE				
Verzioni i shqyrtuar	Data e shqyrtimit	Autori	Aprovuar	Detajet e ndryshimeve
01			ZRRUM 25/05/2011	Dërgimi i parë te KRU
02	9/06/2011	KB	ZRRUM 20/06/2011	- Ridefinimi i aktiviteteve jo-themelore - Ndryshimi i Pikës 5.3.2 - Ndryshimi i Pikës 6.2.2

Përmbajtja

Hyrje	1
1. Përkufizimet.....	2
2. Konceptet e përgjithshme	4
2.1 Udhëzimet e kontabilitetit rregullator.....	4
2.2 Informacionet plotësuese.....	5
2.3 Raportimi	5
3. Aktivitetet	6
3.1 Ndarja e aktiviteteve themelore dhe aktiviteteve jo-themelore.....	6
4. Të ardhurat dhe shpenzimet operative (përfshirë mirëmbajtjen kapitale).....	8
4.1 Të përgjithshme	8
4.2 Të ardhurat	8
4.3 Grantet dhe subvencionet për shpenzimet operative.....	8
4.4 Analiza e shpenzimeve operative për aktivitetet individuale.....	8
4.5 Aktivitetet e shërbimeve - Furnizimi me ujë	8
4.6 Aktivitetet e shërbimeve –Ujërat e Zeza	9
4.7 Zërat e shpenzimeve direkte brenda aktiviteteve të shërbimit	9
4.8 Shpenzimet indirekte - Aktivitetet biznesore (të përbashkëta)	10
4.9 Shpenzimet indirekte- Shpenzimet tjera	11
4.10 Tatimet dhe dividendet	11
4.11 Aktivitetet jo-themelore	11
4.12 Alokimet dhe shpërndarjet.....	11
4.13 Borxhet e konsumatorëve	11
5. Kategoritë e aseteve	13
5.1 Asetet jo-qarkulluese.....	13
5.2 Dallimi në mes të aseteve infrastrukturore dhe jo-Infrastrukturore.....	13
5.3 Shpenzimet kapitale për mirëmbajtjen e infrastrukturës	13
5.4 Klasifikimi i shpenzimeve.....	13
6. Kontimi për mirëmbajtjen kapitale.....	15
6.2 Përritjet infrastrukturore.....	15
7. Baza rregullatore e aseteve	17
7.1 Vlera fillestare e aseteve	17
7.2 Indeksi	17
7.3 Shtesat (asetet jo-infrastrukturore).....	17
7.4 Shtesat (infrastrukturore).....	17
7.5 Largimi nga përdorimi	18
7.6 Zhvlerësimi	18
7.7 Grantet, donacionet dhe kontributet kapitale	18
SHTOJCA 1 – Tabela e analizës së të ardhurave dhe shpenzimeve	19
SHTOJCA 2 – Tabela e bilancit të gjendjes për nevoja rregullatore.....	20
SHTOJCA 3 – Ilustrimi i llogaritjeve të BRA	21
SHTOJCA 4 – Ilustrim i trajtimit rregullator të borxhlinjve	22
SHTOJCA 5 – Përshkrimi i aktiviteteve operative	23
SHTOJCA 6 – Klasifikimi i shpenzimeve kapitale sipas llojit të aseteve dhe qëllimit	29

HYRJE

Ky dokument i Udhëzimeve të Kontabilitetit Rregullator të shërbimeve të Furnizimit me ujë dhe Ujëra të zeza përcakton kërkesat e ZRRUM për informata fillestare për të plotësuar detyrimet e përcaktimit të tarifave duke u bazuar në Procedurat Tarifore për Furnizim me Ujë dhe Ujëra të zeza.

Këto udhëzime bazohen në nevojat për informacione të rregullatorit për qëllime të vendosjes së tarifave dhe në bazë të praktikës së mirë rregullatore, të adoptuar në shumë vende të botës, por të adaptuara për të plotësuar rrethanat specifike dhe mjedisin veprues brenda Kosovës. Në disa fusha këto udhëzime dhe kërkesa për raportim përfshijnë përkufizime dhe procese të evidentuara në udhëzime dhe procedura të agjensive tjera rregullatore të njohura, posaçërisht Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit (Ofwat), rregullator i industrisë së ujit në Angli dhe Uells.

Udhëzimet e kontabilitetit rregullator do të përditësohen dhe ndryshohen nga ZRRUM për të marrë në konsideratë çfarëdo ndryshimi në kërkesat për informacione dhe çështjet të cilat mund të vijnë nga kompanitë e ujit gjatë përgatitjes së llogarive rregullatore.

1. PËRKUFIZIMET

Akruali/parapagimi i përtritjes infrastrukturore: Diferenca në mes të provizionimit të përtritjes infrastrukturore dhe kostos aktuale që është e paraqitur si vlerë kumulative ose si parapagim në bilancin e gjendjes.

Aktivitetet e shërbimit: Aktivitetet e identifikuar individualisht të cilat duhet të kryhen veçmas në mënyrë që të ofrojnë shërbime të furnizimit me ujë dhe ujëra të zeza, kryesisht: resurset dhe trajtimi i ujit, distribuimi i ujit, grumbullimi i ujërave të zeza, trajtimi i ujërave të zeza, si dhe trajtimi dhe derdhja e llumit.

Aktivitetet jo-themelore: Aktivitetet të cilat nuk i nënshtrohen rregullimit nga ZRRUM, p.sh. lëshimi me qira i pajisjeve të ndërtimit palëve të treta, duke përjashtuar këtu ujin e shitur me shumicë, e cila rregullohet nga ZRRUM.

Aktivitetet themelore: Aktivitetet të cilat i nënshtrohen rregullimit nga ZRRUM dhe përfshijnë ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe të ujëra të zeza konsumatorëve të KRU.

Zhvlerësimi i kostos aktuale: Zhvlerësimi i llogaritur në pajtim me metodat e zhvlerësimit sipas kostos aktuale.

Asetet e adoptuara: Asetet fikse të financuara nga ndërmarrësi apo shfrytëzuesi ku prona bartet tek ndërmarrja, vlera e së cilës nuk i shtohet bazës rregullore të aseteve.

Asetet infrastrukturore: Kryesisht asete nëntokësore me jetëgjatësi të pakufizuar dhe të cilat nëse mirëmbahen në mënyrë të duhur do të mund të vazhdojnë me ofrimin e nivelit të përcaktuar të shërbimeve, konsumatorëve, për një kohë të gjatë.

Asetet jo-infrastrukturore: Asete (kryesisht mbitokësore) të cilat kanë një jetëgjatësi të kufizuar prandaj edhe zhvlerësohen gjatë kësaj kohe dhe mund të zëvendësohen në fund të jetës së tyre.

Baza rregullore e aseteve: Baza kapitale e përdorur në vendosjen e limit të tarifave. Kjo është vlera e aseteve të Kompanive Rajonale të Ujit që përfiton kthimin në investime. Kjo paraqet vlerën fillestare të investimeve dhe neto shpenzimet e reja kapitale. Vlera kapitale llogaritet pas zhvlerësimit të kostos aktuale.

Bilanci furnizim-kërkesë: Diferenca në mes të furnizimit dhe kërkesës, ose përmes kërkesës nga konsumatorët e ri apo kërkesës së rritur nga konsumatorët ekzistues për të cilët nevojiten investime shtesë për tu siguruar që kërkesa për shërbime është plotësuar.

Borxhet e pakthyeshme: Lejimi i provizionimit të mospagesës nga ana e Kompanive Rajonale të Ujit për të cilat nuk ka perspektivë të arsyeshme se do të arkëtohen prandaj edhe duhet të kualifikohen si shlyerje të borxhit në pajtim me praktikën konvencionale të kontabilitetit.

Grantet: Të ardhurat (financat) e siguruar për investim apo ofrimin e shërbimeve për të cilat nuk kërkohet ri-pagim. Investimet e infrastrukturës të financuara nga grantet nuk i shtohen as shpenzimeve për përfitjen e infrastrukturës dhe as bazës rregullore të aseteve.

Indeksi: Shpenzimet dhe të ardhurat të përshtatura për inflacion në pajtim me treguesit e inflacionit.

Llogaritë rregullore: Raportimi i informacioneve financiare në pajtim me këto udhëzime.

Kontimi i zhvlerësimit sipas kostos aktuale: Metoda e kontabilitetit, fillimisht e përcaktuar për çështjen e paraqitjes së inflacionit në fitimet e bizneseve. Në vend që asetet të paraqiten me çmimet e tyre historike, (d.m.th me çmimin e tyre origjinal të blerjes), pa zhvlerësim nëse është nevoja, asetet janë më mirë të paraqitura me çmimet aktuale të tyre (koston zëvendësuese), në kohën e krijimit të llogarive. Kjo metodë e kontabilitetit përdoret në industrinë e ujit për shkak të karakterit të gjerë të aseteve kapitale dhe faktit që çmimet historike nuk reflektojnë vlerën e vërtetë të aseteve.

Kontributet kapitale: Të ardhurat e siguruara si kontribute ndaj investimeve nga pala e tretë, p.sh taksat e infrastrukturës dhe kontributet për aktivitetet siç janë devijimet e gypave.

Kostoja funksionale: Shpenzimet direkte të përfshira në provizionimin e çdo shërbimi individual të identifikuar dhe aktivitetet e kompanisë, plus në çdo rast alokimi i shpenzimeve direkte të përfshira në ofrimin e aktiviteteve të përgjithshme dhe mbështetëse.

Kthimi në kapital: Kthimi në bazën rregullatore të aseteve i paraqitur si të ardhura vjetore dhe rritja e kapitalit nga investimet të shprehura si përqindje e investimit origjinal.

Mesatarja e ponderuar e koston kapitale (MPSHK): Mesatarja e ponderuar e interesit të borxhit dhe pritjet e investorit të shprehur si përqindje e kthimit të kapitalit total.

Mirëmbajtja kapitale: Aktiviteti i planifikuar, i kryer nga Kompanitë Rajonale të Ujit për të zëvendësuar dhe riparuar asetet e furnizimit me ujë dhe ujëra të zeza me qëllim të ofrimit të shërbimeve bazë për konsumatorë.

Ngarkesat e shërbimeve: (i) Furnizimi me ujë: pagesat ndaj Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor për nxjerrjen e ujit dhe për palët e treta për shitjen e ujit të blerë me shumicë; dhe (ii) Ujërat e zeza: pagesat ndaj MAPH për lejin e derdhjeve.

Nivelet e ngritura të shërbimit: Përmirësimet e përhershme, të identifikueshme dhe të matshme të niveleve të shërbimeve që janë mbi nivelin aktual bazë.

Plani i biznesit: Paraqitja e planit në ZRRUM, ku përcaktohen aktivitetet e planifikuara dhe shpenzimet (kapitale dhe operative) të cilat e formojnë një pjesë të paraqitjeve të rishqyrtimeve të tarifave të KRU.

Rritja: Rritja e bazës së aseteve përmes niveleve të ngritura të shërbimit dhe/ose zgjerimit të sistemit.

Shërbimet: Shërbimet e furnizimit me ujë dhe shërbimet e ujërave të zeza.

Shpenzimet direkte: Shpenzimet që i atribuohen në mënyrë të drejtpërdrejtë çdo shërbimi individual të identifikuar dhe aktiviteteve të përgjithshme dhe mbështetëse si grup. Shpenzimet e tilla duhet të përfshijnë shpërndarjet kur shpërndarjet e tilla janë të nevojshme për shërbimet operative (për shembull kur ekipi i lëvizshëm përdoret për të kryer veprimet e ujit dhe të ujërave të zeza, apo shpenzimet e veçanta për grumbullim dhe trajtim të ujërave të zeza nuk janë të identifikueshme për fabrikat e vogla të trajtimit të ujërave të zeza).

Shpenzimet e përmirësimit të infrastrukturës: Provizionim vjetor në kontabilitet për shpenzimet e rritjes së vlerës së aseteve të infrastrukturës (d.m.th kryesisht nëntokësore) e paraqitur në pasqyrën rregullatore të të ardhurave.

Shpenzimet e shërbimit: Për çdo shërbim, shuma e shpenzimeve funksionale për çdo aktivitet të shërbimit, plus shuma e shpërndarjeve të duhura në shpenzimet funksionale të aktiviteteve të kompanisë të identifikuar individualisht, plus shpërndarjet e duhura të kostove të çmimeve, borxheve të dyshimta, zërave përjashtues, shlyerjen e aseteve të paprekshme dhe të shpenzimeve të përgjithshme dhe mbështetëse. Në rastin e KRU, kjo do të ketë nevojë për alokimin apo shpërndarjen e shpenzimeve funksionale në lidhje me shërbimin për konsumatorë, shërbimet shkencore, dhe shpenzimet tjera rregullore dhe alokimi apo shpërndarja e kostove të çmimit, borxheve të dyshimta, zërave përjashtues, shlyerjen e aseteve të paprekshme dhe të shpenzimeve të përgjithshme dhe mbështetëse.

Shpenzimet operative: Shpenzimet direkte operative lidhur me ofrimin e shërbimeve që përfshijnë: fuqinë punëtore; energjinë; kemikaljet; materiet konsumuese; shpenzimet e përbashkëta; taksat e pa-rimbursueshme dhe shpenzimet tjera.

Vlera fillestare e asetit: Vlera që i bashkëngjitet BRA në 1 janar 2009 duke u bazuar në kosto të caktuar për kyçje (ujë dhe ujëra të zeza).

2. KONCEPTET E PËRGJITHSHME

2.1 Udhëzimet e kontabilitetit rregullator

2.1.1 Rregullat konvencionale të kontabilitetit të bazuara në çmimet historike dhe metodat konvencionale të zhvlerësimit njihen si metoda të pranueshme të raportimit financiar por kanë një mori kufizimesh, posaçërisht sa i përket kthimit në kapital dhe zhvlerësimit real në industritë kapitale intensive me asete afatgjata siç është industria e ujit. Në praninë e inflacionit këto kufizime shpijnë në:

- Nënvlërësimin e vlerës së aseteve
- Mbivlerësimin e masave të fitimit, dhe rrjedhimisht
- Mbivlerësimin e kthimit në kapital dhe masat e çrregulluara të shpenzimeve të cilat qëndrojnë edhe nëse inflacioni bie në zero.

Mangësitë tjera në rregullat konvencionale të kontabilitetit sa i përket shërbimeve të kompanive kanë të bëjnë me vlerësimin e aktivitetit kur financohen nga grantet apo 'asetet e dhuruara', që shpijnë në:

- Provizionet e zhvlerësimit dhe kthimet në kapital të ngarkuara tarifave në asetet që nuk janë financuar nga kompania, dhe rrjedhimisht
- Tarifa më të larta se sa që do të duhej të ishin, nëse kompania shpërblehet për investimet e saja financiare.

2.1.2 Kontabiliteti rregullator poashtu njeh çasjet e ndryshme që rregullatorët i marrin në lidhje me disa çështje sikurse vlerësimi i aseteve krahasuar me qasjen e marrë në pasqyrat financiare në kontabilitetin konvencional.

2.1.3 Kontabiliteti rregullator përfshinë ri-vlerësimin e strukturave konvencionale të kontabilitetit për të tejkaluar mangësitë e lartpërmendura. Kjo nuk është një alternativë e sistemit të krijuar të kontabilitetit por më tepër kërkon informacione shtesë dhe hollësi se sa ato të nxjerra nga raportimi ekzistues financiar.

2.1.4 Për më tepër, kontabiliteti rregullator përpiqet të përcaktoj të ardhurat reale dhe shpenzimet e ofrimit të shërbimit të furnizimit me ujë:

- Largimit të shpenzimeve dhe të ardhurave të lidhura me aktivitetet jo themelore (nëse ka), p.sh dhënja në huazim e pajisjeve ndërtimore kompanive private;
- Ndarja e shpenzimeve në mes të atyre që kanë lidhje me furnizimin me ujë dhe ujëra të zeza;
- Kategorizimi ndaras i investimeve kapitale sipas qëllimit (mirëmbajtja dhe rritja e kapitalit, me ndarje të mëtejshme të përfitjes në nën-kategori të: kualitetit të përmirësuar, nivelit të përmirësuar të shërbimit dhe bilancit të furnizimit/kërkesës).
- Të krijuarit e një metode alternative për ngarkimin e shpenzimeve të mirëmbajtjes së kapitalit të cilat reflektojnë shpenzimet reale të mirëmbajtjes së aseteve më shumë se sa të provizionimit të zhvlerësimit (kontimi i përfitjes infrastrukture).

2.1.5 Ndonëse kontabiliteti rregullator ka një mori të dallimeve specifike nga kontabiliteti konvencional rregullat të cilat zbatohen në përgatitjen e kontabilitetit rregullator (përveç nëse parashihet ndryshe me këtë dokument) duhet të jenë të njëjta si ato rregulla që zbatohen në kontabilitetin konvencional. Parimet bazë të kontabilitetit (siç është koncepti i akrualit) duhet të zbatohen përveç nëse thuhet ndryshe në mënyrë specifike.

2.1.6 Shifrat të cilat do të përdoren në kontabilitetin rregullator do të derivojnë ose direkt nga regjistrat e kontabilitetit të kompanisë ose do të bazohen në rregullat dhe llogaritjet e paraqitura në këtë dokument. Të gjitha shifrat në kontabilitetin e rregullatorit prandaj duhet t'i gjejmë në shifrat ekzistuese në regjistrat e kontabilitetit të kompanisë apo të llogaritjeve pas udhëzimit nga ky dokument. Edhe në fushat ku informacioni i kërkuar për qëllime të kontabilitetit të rregullatorit dallon nga të dhënat e regjistrave ekzistues të kontabilitetit për qëllime konvencionale të

kontabilitetit (p.sh vlerësimi i asetëve dhe zhvlerësimi) informacionet e rëndësishme në këto llogaritje duhet të gjenden në kontabilitetin rregullator të kompanisë.

2.2 Informacionet plotësuese

- 2.2.1 Këto udhëzime të kontabilitetit rregullator e vendosin minimumin e informacioneve të kërkuara për t'i plotësuar nevojat e rregullatorit. Nëse kompanitë besojnë se ofrimi i informacioneve plotësuese apo analiza e shpenzimeve do të ndihmojë në kuptimin e informacionit i cili është ofruar atëherë ata duhet ta bëjnë një gjë të tillë.

2.3 Raportimi

- 2.3.1 Parimet e kontabilitetit rregullator dhe metodat në këto udhëzime të kontabilitetit rregullator do të vlejnjë për të dyja:

- **Llogaritë rregullatore** – të dhënat historike që i raportohen rregullatorit për t'i lejuar rregullatorit monitorimin e rezultateve të arritura kundrejt projekteve të përdorura në kohën e caktimit të kontrollimit të çmimeve dhe të vlerësojë nivelin e performancës së kompanisë në secilin prej aktiviteteve kyçe; dhe
- **Projeksionet** – në veçanti paraqitja e biznes planit rregullator të rregullatorit për qëllime të vlerësimit të kërkesave për shpenzimet në të ardhmen dhe përcaktimi i tarifave të duhura.

- 2.3.2 Përveç kësaj, ZRRUM mund të kërkojë informacione të kontabilitetit në ndonjë kohë tjetër në mënyrë që të jetë në konsistencë me informacionet e pranuar në kontabilitetin rregullator dhe projektimet e shpenzimeve të ofruara për rregullatorin, këto kërkesa për informacione tjera duhet t'i zbatojnë parimet dhe metodat e udhëzuara.

3. AKTIVITETET

3.1 Ndarja e aktiviteteve themelore dhe aktiviteteve jo-themelore

- 3.1.1 Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet, duke përfshirë investimet kapitale, shpenzimet operative, shpenzimet e përbashkëta, shpenzimet e kapitalit dhe zërat e shpenzimeve jo-kesh për aktivitetet jo-themelore duhet të identifikohen në mënyrë të veçantë nga aktivitetet themelore të ujit dhe ujërave të zeza. Aktivitetet themelore do të përfshihen vetëm në llogaritë e rregullatorit. Të ardhurat, shpenzimet, asetet dhe përgjegjësitë në lidhje me aktivitetet jo-themelore do të paraqiten veçmas.
- 3.1.2 Shembuj ilustrues të dallimeve në mes të aktiviteteve themelore dhe jo-themelore për ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë janë paraqitë në Tabelën 1 më poshtë. Parimet e njëjta duhet të aplikohen edhe për të bërë dallimin në mes të aktiviteteve themelore dhe të aktiviteteve jo-themelore të ujërave të zeza.

Tabela 1 – Aktivitetet themelore/ jo themelore

Aktiviteti	Aktivitete themelore	Aktivitet jo-themelore
Nxjerrja (marrja) e ujit	Nxjerrja e ujit për trajtim dhe shpërndarjen e tij në rrjetin e ujit.	Nxjerrja e ujit për qëllimet e tjera siç është ujitja apo shitjet (e parregulluara) me shumicë të shfrytëzuesit tjetër.
Trajtimi i ujit	Trajtimi i ujit para shpërndarjes së tij në rrjetin e ujit për përdorimin nga konsumatorët brenda zonës së përcaktuar të shërbimit të ofruesve të shërbimit.	Trajtimi i ujit që duhet të i eksportohet ofruesit tjetër të shërbimeve.
Akumulimi i ujit	Akumulimi i ujit të trajtuar dhe të patrajtuar para shpërndarjes së fundit në rrjetin e ujit për përdorim nga konsumatorët brenda zonës së caktuar të shërbimit të ofruesve të shërbimit.	Akumulimi i ujit të trajtuar dhe patrajtuar para eksportimit të ofruesit tjetër të shërbimeve.
Transmisioni dhe shpërndarja e ujit	Transmisioni dhe shpërndarja e ujit në rrjet.	Transmisioni dhe shpërndarja e ujit që duhet të i eksportohet ofruesve tjerë të shërbimeve dhe për shitjet (e parregulluara) me shumicë.
Kyçjet e shtëpive	Instalimi i ri dhe riparimi i kyçjeve ekzistuese të shtëpive brenda zonës së përcaktuar të shërbimit.	Shërbimet e parregulluara komerciale për konsumatorët, p.sh. riparimet në pjesën e poshtme të pikës së furnizimit të shitjeve të ujit (ujëmatës).
Shërbimet e konsumatorëve	Leximi i ujëmatësit, faturimi dhe arkëtimi; vetëdijësimi dhe kampanjë mediale sa i përket sistemit gypor të ujit, etj.	Aktivitetet e shërbimeve të konsumatorëve për shërbimet e parregulluara.
Aktivitetet e tjera		Aktivitetet e parregulluara komerciale p.sh. huazimi i pajisjeve ndërtimore.
Shpenzimet e përbashkëta	Proporcioni i aktiviteteve të përbashkëta që kanë të bëjnë me aktivitetet themelore.	Të gjitha aktivitetet tjera të përbashkëta.

- 3.1.3 Aty ku bëhet ndarja e resurseve në mes të aktiviteteve themelore dhe jo-themelore, duhet të bëhet një shpërndarje e përshtatshme e shpenzimeve në mes të furnizimit me ujë, ujërave të zeza dhe aktiviteteve jo-themelore në llogaritë e rregullatorit në pajtim me udhëzimin në seksionin 4.12.

- 3.1.4 Në mënyrë të ngjashme vlerat e asetëve dhe detyrimeve, duhet të shpërndahen në mes të furnizimit me ujë, ujërave të zeza dhe aktiviteteve jo-themlore në llogaritë rregullatore.
- 3.1.5 Cilido aktivitet, shpenzim apo aset i cili nuk mund të definohet lehtë nga ofruesi i shërbimeve, nëse i përket aktivitetit themelor apo jo-themelor duhet t'i drejtohet ZRRUM për përkufizim.

4. TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET OPERATIVE (PËRFSHIRË MIRËMBAJTJEN KAPITALE)

4.1 Të përgjithshme

- 4.1.1 ZRRUM ka nevojë për një analizë të shpenzimeve operative për një mori qëllimesh duke përfshirë:
- Përcaktimin e tarifave të nevojshme për aktivitetet e Furnizimit me ujë dhe Ujëra të zeza për secilën kompani;
 - Monitorimin e performancës kundrejt projekteve të bëra në kohën kur janë përcaktuar tarifat;
 - Vlerësimin e performancës krahasuese në mes të kompanive për aktivitetet kryesore të lidhura me ofrimin e furnizimit të ujit dhe të shërbimeve të ujërave të zeza; dhe
 - Monitorimin e gjendjes financiare të kompanive rajonale të ujit dhe aftësinë e tyre për të vazhduar financimin e shërbimeve të cilat ata i ofrojnë.
- 4.1.2 Shpenzimet operative, prandaj, edhe nevojiten që të ofrohen nga aktivitetet themelore dhe zërat e shpenzimeve kryesore të identifikuar më poshtë. Aty ku ofrohen shpenzimet kryesore me titullin “te tjera” siç është “Shpenzimet tjera direkte” duhet të bëhet një ndarje e veçantë e këtyre shpenzimeve.
- 4.1.3 Një përshkrim më i hollësishëm i zërave duhet të përfshihet nën secilin shpenzim siç është paraparë në shtojcën 5 dhe shabllonin për raportimin e të ardhurave/shpenzimeve të paraqitur në shtojcën 1.

4.2 Të ardhurat

- 4.2.1 Të ardhurat duhet të paraqiten si shuma e pritur (duke përjashtuar TVSH) nga konsumatorët sa i përket furnizimit të ujit dhe shërbimeve të ujërave të zeza të ofruara gjatë vitit. Shumat e pritura sa i përket ujit dhe ujërave të zeza duhet të paraqiten ndaras.
- 4.2.2 Të ardhurat e pranuar për aktivitetet tjera (për shembull të ardhurat nga furnizimet me shumicë të ujit palëve të treta) duhet të paraqiten si të ardhura jo-themelore.

4.3 Grantet dhe subvencionet për shpenzimet operative

- 4.3.1 Aty ku grantet apo subvencionet pranohen në lidhje me aktivitetet operative, vlera e tyre nuk duhet të zbritet me vlerën e zërave të shpenzimeve operative. Kjo do të sigurojë që zbatimi i shpenzimeve operative për aktivitetet përkatëse mund të monitorohet me kalimin e kohës në mënyrë të kuptimshme edhe nëse niveli i grantit apo subvencionit ndryshon. Gjithashtu do të ndihmojë që të sigurohemi se shpenzimet operative në mes të kompanive (të cilat mund të pranojnë nivele të ndryshme të granteve apo subvencioneve) janë më shumë të krahasueshme.
- 4.3.2 Grantet apo subvencionet e pranuar në lidhje me shpenzimet operative duhet të paraqiten si shuma të veçanta të të ardhurave. Kompanitë duhet të ofrojnë një analizë të veçantë të shpenzimeve operative të granteve apo subvencioneve të shpenzimeve operative duke ofruar hollësi të secilës shumë të pranuar dhe aktivitetin e zërit të shpenzimeve e cila ndërlidhet me të.

4.4 Analiza e shpenzimeve operative për aktivitetet individuale

- 4.4.1 Shpenzimet operative duhet të analizohen te titujt e paraqitur në seksionet prej 4.5 deri në 4.13 me shpenzimet direkte të aktiviteteve kryesore të secilit biznes të paraqitur ndaras.
- 4.4.2 Kompanitë duhet të identifikojnë të gjitha shpenzimet e përgjithshme dhe aktivitetet mbështetëse përbrenda aktivitetit të veçantë siç është definuar.

4.5 Aktivitetet e shërbimeve - Furnizimi me ujë

- 4.5.1 Resurset dhe trajtimi i ujit: Të gjitha shpenzimet direkte të shoqëruara me nxjerrjen e ujit, bartjen dhe trajtimin e ujit të papërpunuar, duke përfshirë mirëmbajtjen rutinore. Të përfshihet kostoja e

blerjes së ujit me shumicë, por të përjashtohet kostoja funksionale e ujit me shumicë për furnizim të palëve të treta dhe të ujit të pa-pijshëm.

- 4.5.2 Distribuími i ujit të trajtuar: Të gjitha shpenzimet direkte të shoqëruara me koston e pompimit, akumulimit dhe bartjes së ujit të trajtuar, duke përfshirë operimin, kontrollimin dhe monitorimin e sistemit të distribuímit, dhe mirëmbajtjen rutinore. Atu ku janë të punësuar punëtorët e distribuímit të ujit në punë që kanë lidhje me çështjet e tarifave dhe pyetjeve rreth faturimit, ata duhet të ngarkohen tek shërbimet e konsumatorëve.
- 4.5.3 Aty ku pompat kryejnë funksione të dyfishta nxjerrjen/distribuímin, duhet të bëhet shpërndarja e shpenzimeve nga secili funksion. Arsytet në bazë të cilave është bërë një shpërndarje e tillë duhet të shpjegohen.

4.6 Aktivitetet e shërbimeve –Ujërat e Zeza

- 4.6.1 Grumbullimi i ujërave të zeza: Përfshijnë të gjitha shpenzimet e shoqëruara me grumbullimin e ujërave të zeza, duke përfshirë shpenzimet e agjensisë dhe mirëmbajtjen rutinore. Përjashtoni kostot e pompimit terminal (d.m.th. kosto e ngarkuar prej stacionit të pompave në fabrikën e trajtimit).
- 4.6.2 Trajtimi i ujërave të zeza: Përfshijnë të gjitha shpenzimet direkte të shoqëruara me trajtimin e ujërave të zeza, duke përfshirë kostot e pompimit terminal dhe mirëmbajtjen rutinore.
- 4.6.3 Trajtimi dhe derdhja e llumit: Përfshirja e të gjitha shpenzimeve direkte të shoqëruara me trajtimin dhe derdhjen e llumit, duke përfshirë mirëmbajtjen rutinore.

4.7 Zërat e shpenzimeve direkte brenda aktiviteteve të shërbimit

- 4.7.1 Për secilin prej aktiviteteve më lartë, shpenzimet duhet të analizohen nën zërat në vijim, siç janë paraqitë në Shtojcën 1:
- 4.7.2 Ngarkesat për shërbime: (i) Furnizimi me ujë: pagesat ndaj Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor për nxjerrjen e ujit dhe për palët e treta për shitjen e ujit të blerë me shumicë; dhe (ii) Ujërat e zeza: pagesat ndaj MAPH për lejimin e derdhjeve.
- 4.7.3 Shpenzimet e energjisë: Të gjitha shpenzimet e energjisë që i atribuohen në mënyrë të drejtpërdrejtë aktiviteteve të shërbimeve të identifikuar por duke e përjashtuar energjinë e përdorur për transport, të cilat përfshihen në shpenzimet e derivateve dhe sigurimin e energjisë në depo dhe zyre, të cilat janë të përfshira në shpenzimet tjera direkte, nëse ndërlidhen drejtpërdrejtë me ndonjë aktivitet të veçantë apo nëse jo me shpenzimet tjera të kompanisë.
- 4.7.4 Shpenzimet e derivateve: Shpenzimet e derivateve të përdorura për transport.
- 4.7.5 Shpenzimet e pagave: Pagat bruto dhe pagat e të gjithë punëtorëve brenda aktivitetit relevant duke përfshirë pagesat të cilat rezultojnë nga bonuset dhe pagesat nga skemat e pagesës së ndërlidhura me fitim, kontributet e sigurimit nga punëdhënësi, detyrimet rrjedhëse të pensioneve, pushimi mjekësor me pagesë, përfitimet nga pushimi mjekësor, siguri i shëndetit privat, shpërblimet e pensionimit, përfitimet e vdekjes gjatë orarit të punës, pushimi me pagesë, mëditjet e udhëtimit dhe shpenzimet e trajnimeve. Aty ku stafi punon në mes të aktiviteteve të ndryshme, shpërndarja e shpenzimeve në mes aktiviteteve preferohet të bëhet përmes përdorimit të pasqyrës së prezencës në punë apo me ndonjë metodë tjetër të regjistrimit të drejtpërdrejtë të kohës së kaluar në ndonjë aktivitet të veçantë.
- 4.7.6 Materialet dhe materiet e konsumueshme: Të gjitha materialet dhe materiet e shpenzueshme të cilat nuk hyjnë tek shërbimet e angazhimit apo kontraktimit. Kjo kategori e shpenzimeve përfshinë pajisjet (siç janë mjetet e vogla dhe veshjet e punës), provizionimet, materialet me bitum dhe rimbushëse, por i përjashton të gjitha zërat e kapitalizuara apo të përfshira brenda kostos së përfitjes së infrastrukturës.
- 4.7.7 Shërbimet e kontraktuara: Të gjitha pajisjet e marra me qira apo të kontraktuara dhe shërbimet. Shërbimet me qira përfshijnë marrjen me qira të makinerisë, zyrës apo pajisjeve të përgjithshme dhe

transportin. Shërbimet e kontraktuara përfshijnë tërë punën e kontraktuar dhe këshillimet profesionale siç janë shërbimet e avokatëve dhe konsulentëve.

4.7.8 Shpenzimet e mirëmbajtjes: Shpenzimet e mirëmbajtjes së aseteve jo-infrastrukturore të lidhura me çdo aktivitet. Përfshihet shpenzimet e mirëmbajtjes së aseteve infrastrukturore të cilat janë të përfshira në koston e mirëmbajtjes së infrastrukturës.

4.7.9 Shpenzimet tjera direkte: Çfarëdo shpenzimi tjetër operativ i ndërlidhur me secilin prej aktiviteteve por duke përfshirë pagesat për kamatë dhe taksa. I përfshihet shpenzimet e ndërlidhura me sigurimin e depove dhe zyrave dhe polisat e sigurimit.

4.8 Shpenzimet indirekte - Aktivitetet biznesore (të përbashkëta)

4.8.1 Shpenzimet indirekte të aktiviteteve të kompanisë duhet të shpërndahen në mes të furnizimit me ujë, aktiviteteve të ujërave të zeza dhe atyre jo-themelore.

- Shërbimet e konsumatorëve: Përfshijnë llogari-mbajtjet e konsumatorëve, leximin e ujmësive, kthimin e borxheve dhe koston e shqyrtimit, pyetjet e konsumatorëve në lidhje me tarifat dhe faturimin si dhe shqyrtimin e ankesave. Kostoja e shërbimeve të blera të faturimit duhet të përfshihet. Kostoja e shërbimeve të tilla të ofruara për palët e treta duhet të përfshihet si aktivitet jo-themelor.
- Shërbimet shkencore: Përfshijnë koston e shërbimeve shkencore dhe laboratorike dhe të monitorimit të kualitetit. Kostoja e shërbimeve të tilla të blera nga palët e treta duhet të përfshihet. Kostoja e shërbimeve të tilla, të ofruara për palët e treta duhet të përfshihet si aktivitet jo-themelor.
- Shpenzimet e rregullatorit: Të përfshihen të gjitha shpenzimet menaxheriale të rregullorëve, pagesa për licencë të cilat i paguhen ZRRUM në lidhje me rregulloren dhe shpenzimet e përfshira të cilat janë bërë me përgatitjen e propozimeve dhe ndërlidhjes me rregullatorët.
- Aktivitetet e përgjithshme dhe mbështetëse: përfshijnë të gjitha shërbimet e ofruara qendrore, përveç për ndonjë zë, i cili mbulohet në mënyrë specifike me aktivitetet e identifikuar individualisht. Duhet të përfshihen shërbimet në vijim:
 - o Shërbimet administrative (duke përfshirë pagat e stafit administrativ)
 - o Shërbimet e menaxhmentit dhe personelit (duke përfshirë pagat e drejtorëve dhe anëtarëve të bordit)
 - o Shërbimet financiare
 - o Shërbimet juridike dhe për menaxhim të pasurisë
 - o Hulumtimet dhe zhvillimi
 - o Përcaktimi i politikave, implementimi dhe monitorimi
 - o Shërbimet e auditorit
 - o Shërbimet e marrëdhënieve me publikun dhe me të punësuarit
 - o Lehtësirat e procedimit të të dhënave
 - o Koordinimi i planifikimit
 - o Automjetet dhe paisjet (duke përfshirë automjetet me qira dhe paisjet e trajtimit të ujit dhe automjetet e kompanisë të lëshuara me qira)
 - o Mundësimi i mirëmbajtjes elektrike dhe mekanike
 - o Toka dhe mirëmbajtja e pasurisë
 - o Deponimi i materialeve-përkrahja operative dhe teknike
 - o Objektet e përgjithshme dhe mbështetëse

- 4.8.2 Këto kosto indirekte do të raportohen për qëllime të planit të biznesit 2012-2014 dhe rishikimin e tarifave në të njëjtën kategori të kostove siç janë përdorë për shpenzimet direkte me përjashtim të kostove të shërbimit (të cilat nuk klasifikohen si shpenzime indirekte). Për rishikimet e tarifave në të ardhmen, shpenzimet do të raportohen në pajtim me kategoritë e kostove të paraqitura më lartë, d.m.th 'Shërbimet për konsumatorë', 'Shërbimet shkencore', 'Kosto e rregullatorit', etj.

4.9 Shpenzimet indirekte- Shpenzimet tjera

- 4.9.1 Borxhet e këqija: Përfshijnë koston e provizionimit të të gjitha borxheve (duke përjashtuar TVSH) të konsumatorëve të cilat janë më të vjetra se një vit, siç janë paraqitë në seksionin 4.13 më poshtë, së bashku me borxhet e këqija specifike më pak se një vit. I përjashton shpenzimet e kthimit të borxheve, të cilat janë të përfshira nën shërbimet e konsumatorëve.
- 4.9.2 Tatimi në vlerën e shtuar e provizionuar kundrejt borxheve të këqija të cilat duhet paguar Qeverisë së Kosovës dhe nuk mund të kthehen për një kohë të tillë deri sa borxhet të shlyhen zyrtarisht në pajtim me rregullat e tatimit të Qeverisë.

4.10 Tatimet dhe dividendet

- 4.10.1 Tatimet e përgjithshme dhe të biznesit për furnizim me ujë dhe shërbimet e ujërave të zeza.
- 4.10.2 Dividentet të cilat i paguhen aksionarëve nga fitimet e biznesit.

4.11 Aktivitetet jo-themelore

Përfshijnë të ardhurat dhe shpenzimet e ofrimit të shërbimeve ndaj palëve të treta duke përfshirë ofrimin e furnizimit me shumicë të ujit të papërpunuar apo të ujit të trajtuar që i furnizon kompanitë tjera, kostoja e prodhimit dhe distribuimit të ujit të pa-pijshëm, kostoja e trajtimit dhe shkarkimit të ujërave të zeza dhe llumit të importuar, kostoja e devijimit të gypave kryesor të ujit dhe të gjitha punëve të tjera të ndërlidhura. Gjithashtu të përfshihen nën aktivitetet jo-themelore të ardhurat dhe shpenzimet e ndërlidhura me aktivitetet tjera të cilat nuk lidhen me aktivitet themelore siç janë të ardhurat e pranura nga përdorimi i asetëve të kompanisë së ujit për aktivitetet e palëve të treta ndërtimore. Nëse shpenzimet e ndërlidhura me këto aktivitete jo-themelore nuk mund të përcaktohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, një shpërndarje e arsyeshme e shpenzimeve mund të bëhet për aktivitetet të cilat e kanë kryer atë shërbim.

4.12 Alokimet dhe shpërndarjet

- 4.12.1 Aty ku është e mundshme, shpenzimet, të ardhurat, asetet dhe detyrimet duhet t'i alokohen në mënyrë të drejtpërdrejtë aktivitetit relevant të shërbimit apo qendrave të kostove.
- 4.12.2 Nëse nuk është e mundshme që të alokohen shpenzimet direkte, kompanitë duhet të bëjnë shpërndarjen e kostove. Baza e shpërndarjes duhet që të reflektojë në mënyrë të drejtë se cila qendër e koston ka shkaktuar koston apo është duke e përdorë asetin. ZRRUM nuk pret që të caktojë ndonjë metodë të veçantë të shpërndarjes që të përdoret nga kompanitë e ujit, por pret që metodat e aplikuara të jenë të arsyeshme dhe të mund të udhëzojnë kompaninë që të ndryshojë metodën nëse ZRRUM beson se metoda e aplikuar nuk është e arsyeshme.
- 4.12.3 Për çdo zë të koston i cili ka më shumë nevojë për një shpërndarje se sa për një alokim të drejtpërdrejtë, baza e shpërndarjes do të vendoset në kontabilitet.
- 4.12.4 Nëse një kompani dëshiron që të ndryshojë bazën e alokimit apo shpërndarjes, duhet të kërkojë aprovimin e ZRRUM për bërjen e këtij ndryshimi. Për të marr miratimin, kompania duhet të ofrojë hollësitë e ndryshimit të propozuar, arsyet për kërkimin e ndryshimit dhe ndikimin e ndryshimit në alokimet/shpërndarjen.

4.13 Borxhet e konsumatorëve

- 4.13.1 Llogaritë e të gjitha kompanive rajonale të ujit përmbajnë shuma të mëdha të papaguara të cilat i janë faturuar konsumatorëve por nuk janë paguar. Shumica prej këtyre shumave janë më të vjetra se një vit. Ndonëse mund të ketë arsye se përse borxhet e tilla të papaguara mbahen në llogaritë

konvencionale, për qëllime të kontabilitetit rregullator, ZRRUM mendon se nuk është e arsyeshme që të mbahen bilance të tilla për një kohë të pacaktuar kur ka shumë pak gjasa që të paguhen.

- 4.13.2 Për qëllime të kontabilitetit rregullator dhe llogaritjes së tarifave, ZRRUM i konsideron të gjitha borxhet e konsumatoreve më të vjetra se një vit si të pakthyeshme, dhe vendos se duhet të shlyhen. Kjo do të thotë se llogaritë rregullatore në fund të secilit vit do të përmbajnë vetëm borxhe të konsumatorëve të cilat ndërlidhen me vitin i cili sapo ka mbaruar.
- 4.13.3 Kostoja e shlyerjes së tillë do të njihet si kosto për qëllime të përcaktimit të tarifave, ndonëse rregullatori mund të dëshirojë që të rishikojë procesin e kthimit të borxheve të kompanisë dhe të sigurohet se janë duke u ndërmarr hapa të arsyeshëm që do të sigurojnë se borxhet janë duke u trajtuar në mënyrë të duhur.
- 4.13.4 Bilanci i borxhlinjëve në fund të çdo viti (duke përfshirë pikënisjen e kontabilitetit rregullator 1 Janar 2009) duhet të derivojë nga një analizë e vjetërsisë së borxheve kur është e mundshme. Nëse kjo nuk është e mundshme, atëherë duhet të përdoret ndonjë metodë për të vlerësuar se borxhet janë më të vjetra se një vit dhe metoda e përdorur duhet të paraqitet qartë.
- 4.13.5 Një shembull i ilustrimit të trajtimit rregullator të borxhlinjëve është paraqitë në Shtojcën 4.

5. KATEGORITË E ASETETEVE

5.1 Asetet jo-qarkulluese

- 5.1.1 Një pjesë e rëndësishme e llogaritjes së tarifave për ndërmarrjet e rregulluara është që të përfshijë një kthim në vlerën e aseteve të tyre. Vlera të cilën e përdorë rregullatori për përcaktimin e tarifave nuk do të jetë medoemos e njëjtë si vlera e përdorur në Pasqyrat Financiare të kompanive të rregulluara. Llogaritë rregullatore do të paraqesin vlerat e aseteve për qëllime rregullatore.

5.2 Dallimi në mes të aseteve infrastrukturore dhe jo-Infrastrukturore

- 5.2.1 Në industrinë e ujit për qëllime të rregullatorit, bëhet një ndarje e rëndësishme në mes të:

a) Aseteve infrastrukturore – ato asete (kryesisht asete nëntokësore) të cilat nëse mirëmbahen në mënyre adekuate, mund të pritët që të ofrojnë një nivel të shërbimit për një kohë të pacaktuar. Këto asete nuk i nënshtrohen zhvlerësimit. Në vend të kësaj, kosto për përfitjen e infrastrukturës (KPI) paraqitet në pasqyrën e të ardhurave për të treguar mirëmbajtjen e servisimit të aseteve nga kompania gjatë vitit siç është paraparë më vonë në seksionin 6.2; dhe

b) Aseteve jo-infrastrukturore – ato asete (kryesisht mbitokësore) të cilat e kanë një jetë të paracaktuar dhe pritët që të mënjanojnë apo të zëvendësohen në fund të jetës së tyre të pritur. Këto asete i nënshtrohen zhvlerësimit gjatë jetëgjatësisë së tyre.

- 5.2.2 Asetet infrastrukturore në përgjithësi përbëhen prej:

- tokës;
- sistemit nëntokësor të gypave të ujit dhe të ujërave të zeza;
- rezervuarëve të mbyllur dhe të deponimit të ujit të patrajtuar me pompim;
- pendave dhe kanaleve;
- gypave të llumit; dhe
- informacioneve në lidhje me asetet infrastrukturore, p.sh. regjistrat e hulumtimit të zonës.

- 5.2.3 Asete tjera (kryesisht mbitokësore) klasifikohen si jo-infrastrukturore.

- 5.2.4 Më shumë udhëzime se cilat asete i takojnë këtyre kategorive, janë paraqitë në Shtojcën 6.

5.3 Shpenzimet kapitale për mirëmbajtjen e infrastrukturës

- 5.3.1 Shpenzimet kapitale për mirëmbajtjen e aseteve infrastrukturore e cila nuk e rrit apo e zgjeron infrastrukturën (d.m.th të mirëmbahet kapaciteti ekzistues dhe niveli i shërbimeve të ofruara nga asetet infrastrukturore) nuk i shtohet bazës rregullatore të aseteve, por financohet përmes kostonë së përfitjes së infrastrukturës (shiko seksionin 6.2).

- 5.3.2 Vetëm ato asete të cilat financohen nga kompania janë të përfshira në Bazën Rregullatore të Aseteve. Çfarëdo rritje apo përfitje e infrastrukturës e cila financohet nga granti apo kontributet kapitale nuk janë të përfshira.

5.4 Klasifikimi i shpenzimeve

- 5.4.1 Duhet të ofrohen të gjitha hollësitë e zërave që i shtohen bazës së aseteve çdo vit. Këto plotësime duhet të kategorizohen sipas qëllimit, ose sipas:

- **Sigurimit të shërbimit bazë**, i cili kërkohet që të mirëmbajë nivelin aktual (bazën e themeluar së fundi) të shërbimeve ndaj konsumatorëve; apo si
- **rritja**, ku ka ngritje të përhershme të nivelit aktual të shërbimit në një nivel “bazik” të ri.

Rritja më tutje ndahet si në vijim:

- o **kualiteti** kur kërkohet shpenzimi për të plotësuar detyrimet e reja ligjore të kualitetit (që nga koha kur është themeluar niveli i shërbimit bazë);
 - o niveli i **rritur** i shërbimeve (NRRSH) ku shpenzimet ofrojnë një ndryshim të identifikueshëm, të matshëm dhe të përhershëm të një shkalle në nivelin e përgjithshëm të shërbimeve për konsumatorët ekzistues mbi standardin e siguruar më parë.
 - o bilanci i **furnizimit/kërkesës** (BFK) ku shpenzimi ofron shërbime të ujit dhe të ujërave të zeza për konsumatorët e ri pa e dëmtuar nivelin aktual të shërbimeve të konsumatorëve ekzistues; dhe/apo e akomodon nivelin e rritur të shërbimeve të ujit nga konsumatorët ekzistues në nivelin aktual të shërbimit.
- 5.4.2 Mirëmbajtja rutinore që nuk përfshihet në shpenzimet kapitale dhe shpenzimet tjera të mirëmbajtjes të cilat bëhen në baza ditore konsiderohen si shpenzime operative dhe merren direkt nga pasqyra e të ardhurave.
- 5.4.3 Shtojca 6 e këtyre udhëzimeve i klasifikon kategoritë e shpenzimeve kapitale si infrastrukture/ jo-infrastrukture dhe sipas qëllimit (Sigurimi i Shërbimit Bazë, Rritja e Kualitetit, NRRSH dhe BFK).
- 5.4.4 Alokimi proporcional i shpenzimeve kapitale kërkohet në mes të kategorive sipas qëllimeve, sipas nevojës, d.m.th. sigurimi i shërbimit bazë, rritja e kualitetit, nivelit të shërbimeve dhe bilanci furnizim/kërkesë. Tri kategoritë e fundit të qëllimeve paraqesin një rritje: një rritje të përhershme të totalit të nivelit të shërbimit ndaj konsumatorëve ekzistues dhe/apo provizionimet ndaj konsumatorëve të ri të nivelit aktual të shërbimit. Projektimet e rritjes mund t'i shërbejnë disa qëllimeve dhe në shumicën e rasteve do të përfshijnë një element të punës së mirëmbajtjes të cilat zbatohen më herët se sa që është e nevojshme. Ky element i avancuar i mirëmbajtjes duhet të alokohet në sigurimin e shërbimit bazë.
- 5.4.5 Aty ku rritjet e nivelit të shërbimeve vijnë nga shpenzimet e kërkuara për kategori të qëllimeve tjera, atëherë vetëm shpenzimet e ngritura, nëse ka ndonjë, duhet t'i alokohen NRRSH. Alokimi në NRRSH duhet të paraqet shpenzimet e bëra vetëm për qëllime të arritjes së përfitjeve të identikuara, të matshme dhe të përhershme në totalin e nivelit të shërbimeve.

6. KONTIMI PËR MIRËMBAJTJEN KAPITALE

- 6.1.1 Asetet infrastrukturore janë ato asete (kryesisht asete nëntokësore) të cilat nuk kanë një jetëgjatësi të caktuar dhe të cilat, nëse mirëmbahen në mënyrë të duhur, mund të vazhdojnë të ofrojnë një nivel të shërbimeve të konsumatorëve për një kohë të pakufizuar.

Asetet jo infrastrukturore janë ato asete (kryesisht mbitokësore) të cilat kanë një jetë të caktuar dhe si të tilla zhvlerësohen gjatë jetëgjatësisë së tyre dhe mund të zëvendësohen në fund të jetës së tyre.

- 6.1.2 Mirëmbajtja kapitale ka të bëjë me mirëmbajtjen e bazës së aseteve ekzistuese (infrastrukturore dhe jo-infrastrukturore) dhe prandaj përbëhet prej të dyjave:

- a) Shpenzimet e përtritjes infrastrukturore – për asete të pa zhvlerësueshme, masa e mirëmbajtjes së këtyre aseteve (infrastrukturore) në atë mënyrë që ato të mbesin të afta për të ofruar një nivel të pritshëm të shërbimeve ndaj konsumatorëve për një të ardhme të pakufizuar; dhe
- b) Zhvlerësimi – masa se si kostoja e një asemi (prandaj edhe kostoja e zëvendësimit të atij asemi) alokohet gjatë jetëgjatësisë së pritur të tij.

6.2 Përtritjet infrastrukturore

- 6.2.1 Kosto e përtritjet së infrastrukturës (KPI) është kostoja vjetore e mirëmbajtjes së asetit infrastrukturor në një nivel të paracaktuar të shërbimeve të konsumatorëve. Kjo shumë duhet të paraqes vlerësimin, nga kompania, të nevojave afatgjate të mirëmbajtjes kapitale për të mirëmbajtur ofrimin e shërbimit të aseteve infrastrukturore dhe kapacitetin operativ.

- 6.2.2 Për qëllime të kontabilitetit konvencional shpenzimet e mirëmbajtjes së këtyre aseteve, të cilat përfshijnë komponentat e riparimeve dhe zëvendësimeve të aseteve, mund të kapitalizohen ose të paraqiten në ndonjë prej llogarive të shpenzimeve operative, por për kontabilitetin rregullator, të gjitha shpenzimet e tilla të cilat krijohen gjatë vitit për mirëmbajtjen e aseteve infrastrukturore paraqiten në provizionimet e përtritjes së infrastrukturës.

- 6.2.3 Vetëm shpenzimi i cili na dërgon drejt rritjes (sa i përket ofrimit të një niveli më të lartë të shërbimeve që i sigurohen konsumatorëve se sa që është menduar më herët) apo zgjerimit (siç është kyçja e zonave të reja në rrjet) do të kapitalizohen. Të gjitha shpenzimet tjera për asetet infrastrukturore duhet të provizionohen kundrejt koston për përtritjen infrastrukturore.

6.2.4 Grantet dhe kontributet për përtritjen infrastrukturore

- 6.2.5 Për qëllime të llogaritjes së tarifave kosto vjetore për përtritjen e infrastrukturës do të reduktohet nga shuma e cila do grant, subvencion apo kontribut që pritet të pranohet për aktivitetet të cilat e përbëjnë mirëmbajtjen infrastrukturore. Kjo është për të siguruar se konsumatorët nuk paguajnë përmes tarifave të tyre për aktivitetet të cilat janë financuar përmes mjeteve tjera.

- 6.2.6 Për të monitoruar shpenzimet për përtritjen e infrastrukturës kundrejt mjeteve të pranuar për përtritjen e infrastrukturës, kompanitë duhet të ofrojnë në kontabilitetin rregullator një analizë të shpenzimeve aktuale dhe gjithashtu të granteve dhe subvencioneve e kontributeve të pranuar për atë shpenzim. Neto shpenzimi (pas zbritjes së subvencionit, grantit apo kontributit, pastaj, mund të krahasohet me shpenzimet për përtritjen e infrastrukturës të cilat janë lejuar në përcaktimin tarifor, për të njohur nëse është shpenzuar më tepër apo me pak kundrejt lejimit.

6.2.7 Akruali/parapagimi i përtritjes infrastrukturore

- 6.2.8 Kostoja e përtritjes infrastrukturore paraqitet në bilancin e gjendjes si provizion (tek detyrimet) dhe shpenzimet aktuale për mirëmbajtjen e aseteve infrastrukturore merren njëjtë si vlera e provizionuar dhe nuk paraqiten në pasqyrën e të ardhurave apo të kapitalizohen. Çfarëdo dallimi prej vitit në vit në mes të koston për përtritjen e infrastrukturës dhe shpenzimeve aktuale të bëra, akumulohen në bilancin e gjendjes si një akrual kumulativ apo parapagim sipas nevojës. Kjo përcaktohet ndaras për secilin prej sistemeve infrastrukturore të ujit dhe të ujërave të zeza dhe përfshihet si një lejim financiar në llogaritjet përkatëse për përcaktimin e tarifave.

6.2.9 Akruali apo parapagimi për përtritjen e infrastrukturës paraqet, ose:

- Paratë të cilat janë pranuar përmes tarifave për përtritjen infrastrukturore të cilat nuk janë shpenzuar, por do të duhet të shpenzohen në mënyrë që të sigurohen se asetet do të mbesin të afta që të ofrojnë nivelin e nevojshëm të shërbimit; apo
- Punën e cila është kryer paraprakisht para pranimi të fondeve përmes tarifave, në mënyrë që të mirëmbahet aftësia e shërbimit të aseteve dhe të cilat do të financohen përmes, përtritjes infrastrukturore, në tarifën e viteve të ardhshme.

6.2.10 Aty ku akruali apo parapagimi i rritjes infrastrukturore grumbullohet në nivele të konsiderueshme, ZRRUM do të dëshironte të shqyrtonte arsyet për këtë pasi që kjo mund të jep indikacion se ka problem me nivelin e lejimeve të rritjes infrastrukturore që është përcaktuar, ose se ka problem të vazhdueshëm me shpenzimet e bëra mbi/nën vlerën e rritjeve infrastrukturore të kompanisë.

7. BAZA RREGULLATORE E ASETERVE

7.1 Vlera fillestare e asetëve

- 7.1.1 Metodologjia për tarifa e përdorur nga ZRRUM fillon me 1 Janar 2009 me bazën rregullatore të asetëve (BRA) për secilën prej kompanive të ujit, duke përdorur vlerën e përcaktuar të asetëve prej €200 për konsumatorët e shërbimit të furnizimit me ujë dhe €100 për konsumatorët e ujërave të zeza, të KRU.
- 7.1.2 Këto vlera fillestare për ujë dhe ujëra të zeza shpërndahen në mes të asetëve infrastrukturore dhe jo infrastrukturore duke i përdorë proporcionet e asetëve të tilla në regjistrat e asetëve të kompanisë.

7.2 Indeksi

- 7.2.1 Për të mirëmbajtur vlerën e bazës rregullatore të asetëve në kushte reale është e nevojshme që të aplikohet një faktor i inflacionit çdo vit. Qasja e adoptuar nga metodologjia e tarifave të ZRRUM përdor Indeksin e Çmimit të Konsumit për Kosovë siç është publikuar nga Zyra Statistikore e Kosovës. Vlera mbyllëse e asetëve në vitin n rritet në një vlerë për vlerën hyrëse në vitin $n+1$ duke e përdorë formulën në vijim:

$$RAB_{n+1} = RAB_n \times \frac{CPI_{n+1}}{CPI_n}$$

Ku:

RAB_n = vlera e Bazës Rregullatore të Asetëve në vitin n

RAB_{n+1} = vlera e Bazës Rregullatore të Asetëve në vitin $n+1$

CPI_n = mesatarja e TÇK për vitin n siç është publikuar nga Zyra Statistikore e Kosovës

CPI_{n+1} = mesatarja e TÇK për vitin $n+1$ siç është publikuar nga Zyra Statistikore e Kosovës.

- 7.2.2 Asetet e përvetësuara gjatë vitit nuk do të kenë nevojë për indeksim pasi që ato veç janë në bazën e çmimit të saktë.
- 7.2.3 Llogaritja e zhvlerësimit do të bazohet në vlerat hyrëse të indeksimit dhe prandaj do të jenë edhe ato në bazën e çmimit të saktë.

7.3 Shtesat (asetet jo-infrastrukturore)

- 7.3.1 Asetet e reja hyjnë në bazën rregullatore të asetëve vetëm në kohën e vënjes në përdorim, d.m.th. kur ato i ofrojnë shërbime konsumatorëve. Vlera në të cilën ato shtohen në bazën rregullatore të asetëve është kosto e asetit duke përfshirë koston e instalimit dhe çfarëdo interesi të zbatueshëm të bërë gjatë ndërtimit. Interesi gjatë ndërtimit duhet të llogaritet nga mesatarja e ponderuar e kostos kapitale (MPKK) për tu siguruar se asetet gjatë ndërtimit të fitojnë të njëjtën vlerë të kthimit si asetet në përdorim.
- 7.3.2 Nëse një aset është financuar plotësisht nga grantet apo kontributet kapitale, nuk përfshihet në bazën rregullatore të asetëve. Të vetmet asetë të cilat duhet të përfshihen janë ato të cilat janë financuar nga kompania, pasi që vetëm kjo shumë duhet të fitojë vlerën e kthimit dhe të zhvlerësimit përmes tarifave të konsumatorëve.
- 7.3.3 Nëse aset është financuar pjesërisht nga grantet apo kontributet kapitale, vetëm pjesa e cila është financuar nga kompania (d.m.th. totali i kostos më pak se vlera e grantit/kontributit) duhet të përfshihet në bazën e asetit si një shtesë.

7.4 Shtesat (infrastrukturore)

- 7.4.1 Shpenzimet kapitale për asetet infrastrukturore i shtohen bazës rregullatore të asetëve vetëm nëse rritet ose zgjerohet shërbimi i ofruar nga baza e asetëve ekzistuese (p.sh zgjerimi i rrjetit për të kështur pronat e reja). Shpenzimet kapitale për asetet infrastrukturore të cilat kërkojnë vetëm të

mirëmbajnë nivelin aktual të shërbimit dhe standardit nuk i shtohen bazës rregullatore të aseteve, por mbulohen përmes kostos për përfitjen infrastrukturore (shiko seksionin 6.2).

7.5 Largimi nga përdorimi

- 7.5.1 Të ardhurat nga largimi i i aseteve jo qarkulluese (infrastrukturore dhe jo infrastrukturore) duhet të regjistrohen kundrejt kostos së shtesave në vit në mënyrë që baza rregullatore e aseteve të rritet nga investimet neto në asete të reja. Kjo duhet të bëhet veçmas për asetet e furnizimit me ujë, ujërave të zeza, aseteve infrastrukturore dhe jo-infrastrukturore.

7.6 Zhvlerësimi

- 7.6.1 Për thjeshtësim të gjitha asetet e zhvlerësueshme (d.m.th asetet jo-infrastrukturore) grumbullohen në Bazën Rregullatore të Aseteve dhe zhvlerësohen gjatë jetëgjatësisë mesatare të aseteve. Kjo jetëgjatësi mesatare e aseteve është përcaktuar të jetë 35 vjet duke u bazuar në rishikimin e aseteve të mbajtura nga të gjitha kompanitë e ujit në Kosovë.
- 7.6.2 Për qëllime të kontabilitetit rregullator të gjitha asetet jo infrastrukturore të vëna në përdorim në vitin financiar konsiderohen si të vëra në përdorim në mesin e vitit, p.sh. 30 Qershor dhe në këtë mënyrë do të fitojnë gjysmë viti zhvlerësim në atë vit.
- 7.6.3 Vlera e zhvlerësimit prandaj është $1/35$ e vlerës fillestare të bazës rregullore të aseteve (të indeksuara deri në çmimet e vitit aktual) plus $0.5 \times 1/35$ e kostove shtesë gjatë vitit.
- 7.6.4 Pasi që vlera fillestare e BRA është përshtatur me nivelin e çmimeve aktuale çdo vit duke e përdorur mesataren e statistikave të IÇK, dhe shpenzimet shtesë janë tashmë në çmimet aktuale, kjo metodë siguron që zhvlerësimi në kontabilitetin rregullator është gjithnjë në kushte të çmimeve aktuale prandaj do të jetë e mjaftueshme për të lejuar zëvendësimin e atyre aseteve në fund të jetëgjatësisë së tyre.

7.7 Grantet, donacionet dhe kontributet kapitale

- 7.7.1 Asetet të cilat janë financuar nga grantet, donacionet, të ndërtuara nga palët e treta dhe të adoptuara nga KRU pa ngarkesë apo kontribute kapitale nuk përfshihen në bazën rregullatore të aseteve dhe asetet të cilat financohen pjesërisht përfshihen vetëm në atë nivel që janë financuar nga kompania. Prandaj nuk ka zhvlerësim të këtyre aseteve dhe konsumatorët nuk duhet paguar tarifat e aseteve të cilat kompania nuk i ka financuar vetë.

SHTOJCA 1 – TABELA E ANALIZËS SË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

	Furnizimi me Ujë			Shërbimet e Ujërave të Zeza				Aktivitete jo-themelore
	Resurset dhe trajtimi i ujit	Distribuími i Ujit	Totali i Furnizimit me Ujë	Ujërat e zeza	Trajtimi i Ujërave të zeza	Trajtimi dhe derdhja e llumit	Totali për Ujëra të zeza	
	€	€	€	€	€	€	€	
Të ardhurat			xxx				xxx	xxx
Grantet dhe subvencionet e pranuar			xxx				xxx	xxx
Shpenzimet direkte								
Ngarkesat e shërbimeve	xxx	xxx	kalk	xxx	xxx	xxx	kalk	xxx
Shpenzimet e energjisë	xxx	xxx	kalk	xxx	xxx	xxx	kalk	xxx
Shpenzimet e derivateve	xxx	xxx	kalk	xxx	xxx	xxx	kalk	xxx
Shpenzimet e pagave	xxx	xxx	kalk	xxx	xxx	xxx	kalk	xxx
Shpenzimet e materialit dhe materieve të konsumueshme	xxx	xxx	kalk	xxx	xxx	xxx	kalk	xxx
Shpenzimet e shërbimeve të kontraktuara	xxx	xxx	kalk	xxx	xxx	xxx	kalk	xxx
Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit	xxx	xxx	kalk	xxx	xxx	xxx	kalk	xxx
Shpenzimet tjera direkte	xxx	xxx	kalk	xxx	xxx	xxx	kalk	xxx
Totali i shpenzimeve direkte	kalk	kalk	kalk	kalk	kalk	kalk	kalk	kalk
Shpenzimet indirekte								
Aktivitetet biznesore (të përbashkëta)								
Shpenzimet e energjisë			xxx				xxx	xxx
Shpenzimet e derivateve			xxx				xxx	xxx
Shpenzimet e pagave			xxx				xxx	xxx
Shpenzimet e materialit dhe materieve të konsumueshme			xxx				xxx	xxx
Shpenz. e shërb. të kontraktuara			xxx				xxx	xxx
Shpenz. e mirëmb. dhe riparimit			xxx				xxx	xxx
Shpenzimet tjera indirekte			xxx				xxx	xxx
Total i shpenz. të aktiviteve biznesore			kalk				kalk	kalk
Shpenzimet tjera indirekte								
Borxhet e këqija			xxx				xxx	xxx
TVSH e borxheve të këqija			xxx				xxx	xxx
Total i shpenz. tjera indirekte			kalk				kalk	kalk
Total i shpenz. indirekte			kalk				kalk	kalk
Mirëmbajtja kapitale				xxx	xxx	xxx		
Përritjet infrastrukturore	xxx	xxx	kalk	xxx	xxx	xxx	kalk	xxx
Zhvlerësimi								
- Aktivitet e shërbimit	xxx	xxx	kalk	xxx	xxx	xxx	kalk	xxx
- Aktivitete e biznesit			xxx				xxx	xxx
Totali i mirëmbajtjes kapitale	kalk	kalk	kalk	kalk	kalk	kalk	kalk	kalk
Totali i të ardhurave para-taksimit			kalk				kalk	kalk

Çelësi

Për tu plotësuar

Kalkulimet automatike

Nuk kërkohet

xxx
Kalk.

SHTOJCA 2 – TABELA E BILANCIT TË GJENDJES PËR NEVOJA RREGULLATORE

	Ujë	Ujëra të zeza	Aktivitet jo -themelore
	€	€	€
Asetet jo-qarkulluese (BRA)			
Asetet infrastrukturore			
Asetet jo infrastrukturore			
Totali i aseteve jo qarkulluese	0	0	0
Asetet qarkulluese			
Stoqet			
Borxhlinjtë			
Parapagimet dhe të ardhurat akruale			
Paratë e gatshme			
Asetet tjera qarkulluese			
Totali i aseteve qarkulluese	0	0	0
Totali i aseteve	0	0	0
Ekuiteti rregullator			
Detyrimet jo-qarkulluese			
Kreditë > 1 vit			
Detyrimet tjera > 1 vit			
Totali i detyrimeve jo- qarkulluese	0	0	0
Detyrimet qarkulluese			
Detyrimet e tregut			
Depozitat e konsumatorëve			
Kreditë < 1 vit			
Detyrimet tjera qarkulluese			
Totali i detyrimeve qarkulluese	0	0	0
Totali i kapitalit dhe detyrimeve rregullatore	0	0	0

SHTOJCA 3 – ILUSTRIMI I LLOGARITJEVE TË BRA

		Ujë		Ujërat e zeza		Totali
		Inf.	Jo-inf.	Inf.	Jo-inf.	
BRA në 31.12.2009 me çmimet e vitit 2009		4,399,084	1,175,908	1.098,777	67,612	6,741,280
Përshtatjet e indeksimit me çmimet e vitit 2010						
Mesatarja e IÇK në Kosovë në 2009	109.7					
Mesatarja e IÇK në Kosovë në 2010	113.5	152,384	40,733	38,062	2,339	
Vlera e BRA në hyrje të 2010 me çmime të 2010		4,551,468	1,216,641	1,136,838	69,850	6,974,797
Shtesat (zvogëluar për largimi nga përdorimi)						
Rritje infrastrukture		6,000		1,500		
Shtesat jo-infrastrukture			600		250	
Zhvlerësimi			-34,770		-1999	
Mesatarja e Jetëgjatësisë së Asetit (në vite)	35					
Vlera BRA e asetit më 31.12.2010 siaps çmimeve të 2010		4,557,468	1,182,471	1,138,338	68,101	6,946,378

SHTOJCA 4 – ILUSTRIM I TRAJTIMIT RREGULLATOR TË BORXHLINJVE

Borxhlinjtë			
Përcjellur para	45		
Shitjet	100	Pranimet	70
		Shlyerjet në Pasqyrën e të ardhurave	35
		Përcjellur para	40
	<u>145</u>		<u>145</u>

Me lartë shifra e përcjellë 45 paraqet borxhlinjtë në fillim të vitit të cilat janë më pak se një vit të vjetëra. Shifra vjen nga analiza e vjetërsisë së borxhlinjve në fund të vitit të kaluar.

Shifra e shitjes paraqet shumën e shitjes të faturuar gjatë vitit (duke përfshirë TVSH).

Shifra e pranimet paraqet pagesat të cilat janë pranuar gjatë vitit.

Bilanci i përcjellur në vitin tjetër prej 40 paraqet borxhlinjtë në fund të vitit aktual të cilët janë më pak se një vit të vjetër. Shifra vjen nga një analizë e vjetërsisë së borxheve në fund të vitit aktual. Kjo është shifra e cila duhet të paraqitet në bilancin gjendjes rregullatore për borxhlinjtë.

Shifra prej 35 është shifra e bilancit dhe është shuma e cila i provizionohet pasqyrës rregullatore të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Pasi që shitjet gjatë vitit kanë qenë 100 dhe bilanci i përcjellur para (i cili paraqet shumat e papaguara vetëm prej shitjeve gjatë vitit) është 40, kjo do të thotë se 60 prej pranimeve kanë qenë në lidhje me shitjet gjatë vitit.

Bilanci i përcjellur para, i cili tani paraqet shitjet të cilat janë më të vjetra se një vit, ka prodhuar 10 (=70 minus 60) nga pagesat e pranuar dhe shifra e mbetur prej 35 është shuma e cila është shlyer në pasqyrën e të ardhurave.

SHTOJCA 5 – PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE OPERATIVE

Aktivitetet e shërbimit – Furnizimi me ujë

Resurset dhe trajtimi

Zërat që duhet të përfshihen	Përshkrimi
Pompimi me ngritje të ulët	Operimi, mirëmbajtja dhe kosto e energjisë për pompa, objekte dhe pajisje të përdorura për nxjerrje, bartje për trajtim dhe trajtimi (d.m.th e përjashton pompimin me ngritje të lartë për ta transferuar në rezervuaret e shërbimit apo shtytjen në/ brenda sistemit të distribuimit).
Trajtimi i ujit të papërpunuar	Aktivitetet e shoqëruara me trajtimin e ujit të papërpunuar nga të gjitha burimet-kemikaljet e përdorura për në trajtimin e ujit dhe shpenzimet e tjera të përfshira; trajtimi dhe derdhja e llumit dhe ujërave të zeza; ngritja e shtratit të filtrave të rrës kur është e nevojshme, pompimi ndër-procesor; provizionimi, operimi dhe mirëmbajtja rutinore e fabrikës fikse.
Operimi dhe mirëmbajtja rutinore e gypave të ujit të papërpunuar dhe akueduktët	Operimi, riparimi dhe mirëmbajtja e gypave për uje te papërpunuar , operimi me valvul, pastrimi dhe testimi, inspektimi i vazhdueshëm i gypave kryesor, trajtimi fillestar me kemikalje për te mirëmbajtur rrjedhjen e ujit përmes akueduktëve.
Detektimi i humbjeve të ujit	Dëgjimi me sonda, rrjedhjet e ujit dhe testimi i hapave, dhe përdorimi specifik i të gjitha pajisjeve për matje të rrjedhjes për detektim të ujit brenda sistemit të ujit të papërpunuar, mirëmbajtja e korrelatorëve dhe pajisjeve tjera, ujëmatësit dhe pusetat. Blerja dhe grumbullimi i hartave dhe logerëve.
Operimi dhe mirëmbajtja rutinore e rezervuarëve	Operimi dhe mirëmbajtja rutinore e rezervuarëve të ujit të papërpunuar duke përfshirë: mirëmbajtjen rutinore të strukturave të pendave dhe valvulave dhe mekanizmat ne dalje; dhe operimi i valvulave të shkarkimit.
Shpenzimet e përgjithshme	Pagesat për nxjerrjen e ujit, dhe blerja e ujit me shumicë.
Administrimi, mbikëqyrja dhe menaxhimi	Shpenzimet direkte të administrimit, mbikëqyrja dhe menaxhimi duhet të identifikohen dhe alokohen për secilin aktivitet sipas nevojës.

Distribuimi

Zërat që duhet të përfshihen	Përshkrimi
Pompimi me ngritje të lartë	Operimi, mirëmbajtja dhe shpenzimet e energjisë për pompa, objekte dhe pajisje të përdorura për bartje të ujit në rezervuare të shërbimit apo për shtytje në/ brenda sistemit të distribuimit .
Operimi dhe mirëmbajtja rutinore e rezervuarëve të shërbimit dhe të shtyllave	Operimi dhe mirëmbajtja rutinore e rezervuarëve të shërbimit dhe shtyllave, mirëmbajtja rutinore e ventileve dhe kapakëve; riparimet e vogla dhe mirëmbajtjet e valvuleve dhe puseatve të valvulave, mbi-rrjedhjet dhe kanalet ku zbrazja e rezervuarëve është e nevojshme; inspektimi për vlerësimin e sigurisë së rezervuarëve si dhe kushtet strukturore dhe konfiguracioni i terrenit.
Pastrimi i rezervuarëve	Pastrimi dhe punët riparuese të rezervuarëve- mbyllja e valvuleve dhe devijimi i furnizimeve, sigurimi i sterilizimit, pastrimi dhe pajiset e ndriçimit; mënjanimi i reshjeve; pastrimi; rimbushja, testimi i dezinfektimit; operimi i akueduktëve në furnizim.
Operimi dhe mirëmbajtja rutinore e akueduktëve dhe gypave	Të gjitha riparimet e gypave – operimi i valvuleve, riparimet aktuale; lëshimi i ujit në gypa, dezinfektimi dhe testimi, rimbushja, rivendosja, ri-kyçja; operimi i akueduktëve dhe gypave.
Operimi dhe mirëmbajtja rutinore e valvulave dhe aparaturave të ngjashme	Riparimi dhe mirëmbajtja e valvulave të ajrit, të ujit, hidraulikeve dhe valvuleve tjera, dhe rezervuarët për reduktim te presionit. (Përfshijnë riparimet e pusetave dhe kapakëve dhe mbyllja dhe hapja e valvuleve për te kontrolluar operimin e kënaqshëm). Provizionimi i valvuleve dhe aparaturave të ngjashme në sistemin e distribuimit.
Riparimi dhe mirëmbajtja e shërbimeve	Riparimi dhe mirëmbajtja e shërbimeve nga unaza metalike deri te valvula për mbyllje në kufi. Mbylljet e valvulave, njoftimet, furnizimet e përkohshme, etj.
Zëvendësimi dhe riparimi i ujëmatësve	Kalibrimet për ndërrime dhe riparimet e ujëmatësve zonal (duke i përjashtuar ujëmatësit e ujit të humbur).
Riparimet e vogla të ujëmatësve të konsumatorëve në terren	Çfarëdo pune e kryer në terren për të riparuar ujëmatësit.
Instalimi i ujëmatësve të konsumatorëve dhe zëvendësimi i tyre	Instalimi, largimi dhe zëvendësimi i ujëmatësve të konsumatorëve (por përjashtohet blerja dhe shpenzimet për përfitjen e ujëmatësve të cilat kapitalizohen apo i'u ri-provizionohen konsumatorëve).
Operimi dhe kontrollimi i sistemit të distribuimit	Monitorimi i presionit të kënaqshëm dhe kualitetit të ujit. Regjistrimi i presionit dhe testimi, matja e rrjedhjes dhe leximi i nivelit te rezervuarëve. Operimi i valvulave të ajrit, ujit, dhe përshtatjet e VUP (valvula e uljes së presionit). Pastrimi, lëshimi i ujit, dhe njoftimi i konsumatorëve (duke përjashtuar çfarëdo pune e cila është e përfshirë si përfitjen e infrastrukturës). Post Trajtimi rutinor, dezinfektimi dhe dozimi i kemikaljeve për kontrollin lokal; dhe kontrollimi i mbushjes duke përfshirë marrjen e mostrave dhe njoftimin.

Zërat që duhet të përfshihen	Përshkrimi
Detektimi i ujit të humbur	Dëgjimi me sonda, rrjedhjet e ujit dhe testimi i hapave dhe përdorimi specifik i të gjitha pajisjeve për matjen e rrjedhjes për detektim të ujit të humbur brenda sistemit të distribuimit, mirëmbajtje së korrelatorëve dhe pajisjet e tjera për ujëra të zeza, ujëmatësit e ujërave të zeza dhe pusetat. Blerja dhe grumbullimi i hartave, logerëve.
Inspektimi i rregulloreve	Kontrollimi i instalimeve, dhënia e këshillave dhe zbatimi i marrëveshjeve, duke përfshirë inspektimin e kyçjeve të reja të amvisërisë dhe kyçjeve të bizneseve; inspektimi i pronave ekzistuese kur të bëhen ndërrimet e gypave të ujit dhe ekziston rreziku nga kontaminimi dhe kyçjeve periodike; inspektimi i vendeve industriale dhe fermave (gjithashtu duke përfshirë para dhe post inspektimet e pronave të amvisërisë dhe të bizneseve gjatë instalimit të ujëmatësve të konsumatorëve).
Shqyrtimet e pyetjeve dhe ankesave	Aktivitetet që dalin nga pyetjet dhe ankesat në lidhje me sistemin e distribuimit nga konsumatorët, kontraktorët apo të shërbimeve tjera, duke përfshirë kontrollimet në terren, përdorimi i pajisjes për gjetjen e gypave dhe çfarëdo pjesëmarrje në terren gjatë gërmimeve. Shqyrtimet e ankesave të shtypjes së ulët, apo furnizimit të pamjaftueshëm, duke përfshirë kontrollimet në terren, testimi i shtypjes, marrja e mostrave, pastrimi i gypave dhe kompensimi për dëmin e shkaktuar pronës së konsumatorit.
Mbikëqyrja e administratës dhe menaxhimi	Të gjitha shpenzimet direkte të konsumatorëve, mbikëqyrja dhe menaxhimi duhet të identifikohen dhe alokohen në këtë aktivitet të nën shërbimit sipas nevojës. Vërejtje: 1 aty ku pompat kanë funksion të dyfishtë të ngritjes së ulët/ngritjes së lartë duhet të bëhet një vlerësim i kostove të secilit funksion duke u bazuar në zërin e caktuar për pompim. 2 Kur stafi i distribuimit janë të punësuar në punën e ndërlidhur me tarifën dhe pranimin e ankesave rreth faturimit, ato duhet të provizionohen në “Shërbimet e Konsumatorëve”.

Aktivitet e shërbimit – Shërbimet e ujërave të zeza

Grumbullimi i ujërave të zeza

Zërat që duhet të përfshihen	Përshkrimi
Inspektimi i ujërave të zeza, vërshimi nga stuhitë dhe shkarkimi i tyre.	Inspektimi i gypave të ujërave të zeza duke përfshirë CCTV ekzaminimet e mirëmbajtjes dhe inspektimin fizik të pusetave
Pastrimi i gypave të ujërave të zeza duke përfshirë pastrimin me presion, dhe derdhjen e ujit.	Nxjerrja me forcë dhe me çikrik për të pastruar copërat apo llumit në gypa të ujërave të zeza, pusetave, vërshimet nga stuhitë, sifonet, rezervuarët, gypat ne ngritje dhe strukturat tjera.
Blokimet e gypave të ujërave të zeza	Pastrimi i bllokadave duke përfshirë lëshimin e ujit, nxjerrjen me forcë etj. që kanë të bëjnë me pastrimin e bllokimeve.
Mirëmbajtja e gypave dhe riparimi duke përfshirë pusetat dhe punët emergjente	Riparimet rutinore të gypave të ujërave të zeza, zëvendësimi i kapakëve të pusetave, riparimet e pusetave, strukturat dhe linjat e gypave përmes metodave të përtritjes e punëve të tjera të natyrës periodike. Përtritja, zgjerimi, riparimi, zëvendësimi dhe përtritja e gypave të ujërave të zeza dhe strukturave duke përfshirë ndërrimin e gypave.
Inspektimi dhe mirëmbajtja e operimeve të stacioneve të pompimit	Inspektimi dhe mirëmbajtja rutinore e stacioneve të pompave dhe pajisjeve të përfshira, duke përfshirë ndarëset; mirëmbajtja e pusetave, lyerja me vaj. (NB Përfshihet stacionet terminale të pompave të cilat duhet të provizionohen në trajtimin e ujërave të zeza dhe shkarkimin e tyre).
Operimet me pompa	Energjia dhe shpenzimet tjera të përfshira në operim dhe mirëmbajtje të stacioneve të pompave. (NB Përfshihet stacionin terminal të pompave; të cilat duhet të provizionohen në trajtimin e ujërave të zeza dhe shkarkimin e tyre.)
Regjistrat e gypave të ujërave të zeza	Përmirësimet e pajtuara për regjistrat e gypave të ujërave të zeza.
Shqyrtimet e pyetjeve dhe ankesave	Aktivitetet të cilat derivojnë nga pyetjet dhe ankesat e konsumatorëve në lidhje me sistemin e ujërave të zeza, punët e kontraktorëve, dhe shërbyes tjerë duke përfshirë kontrollimet në terren, përdorimin e pajisjeve për gjetjen e gypave dhe çfarëdo pjesëmarrje tjetër në terren gjatë gërmimeve.
Administrimi, mbikëqyrja dhe menaxhimi	Të gjitha shpenzimet e administrimit, mbikëqyrjes dhe menaxhimit duhet të identifikohen dhe alokohen në këtë nën aktivitet sipas nevojës.

Trajtimi i ujërave të zeza

Zërat që duhet të përfshihen	Përshkrimi
Pompimi i ujërave të zeza	Pompimi i ujërave të zeza të papërpunuara, ujërat e zeza nga reshjet dhe rrjedhjet që vijnë nga burimet tjera në proceset preliminare/primare të trajtimit apo nga rrjedha e ujit. Shpenzimet duhet të përfshijnë të gjitha aspektet e operimeve dhe mirëmbajtjes rutinore.
Provisionimi i trajtimit preliminar	Operimi dhe mirëmbajtja rutinore e ndarjes, thërrmimit, zbutjes, largimi i rërës dhe rezervuarët e reshjeve.
Provizionimi i trajtimit primar	Operimi dhe mirëmbajtja rutinore e të gjitha aspekteve të proceseve të sendimentimit primar për të përfshirë ndarjen e llumit me pompim direkt apo me çfarëdo mjeti tjetër në fazën e parë të trajtimit të llumit.
Filtrimi	Operimi dhe mirëmbajtja rutinore e filtrimit biologjik për të përfshirë koston e aktiviteteve të rezervuarit me humus dhe pompimin e brendshëm të rrjedhës.
Proceset e aktivizuara të llumit	Operimi dhe mirëmbajtja rutinore e proceseve të aktivizuara të llumit për të përfshirë shpenzimet e aktivitetet e rezervuarit të përpunimit të llumit, kthimin e llumit të pompuar, energjinë dhe fabrikën e jashtme.
Trajtimi terciar	Operimi dhe mirëmbajtja rutinore e proceseve terciare të trajtimit dhe filtrat me nitrate për të përfshirë procesin e pompimit.
Menaxhimi i mbikëqyrjes administrative	Të gjitha shpenzimet direkte të administrimit, mbikëqyrjes dhe menaxhimit duhet të identifikohen dhe alokohen në këtë nën aktivitet sipas nevojës.

Trajtimi dhe derdhja e llumit

Zërat që duhet të përfshihen	Përshkrimi
Trashja e llumit me anë të rënies së lirë dhe proceset me energji të ulët	Operimi dhe mirëmbajtja rutinore me rënie të lirë dhe proceset me energji të ulët, për të përfshirë shpenzimet e mbajtjes para se të shkarkohen në rezervuar të trashjes së llumit.
Tretja e llumit	Operimi dhe mirëmbajtja rutinore e proceseve të shoqëruara me tretjen anaerobe të llumit për të përfshirë para trashjen, tretjen primare, tretjen sekondare, duke përfshirë koston e mbajtjes së mëtejme para trajtimit shtesë apo shkarkimit.
Largimi i ujit nga llumi në mënyrë mekanike	Operimi dhe mirëmbajtja rutinore e proceseve për të larguar ujin nga llumi i ujërave të zeza në mënyrë mekanike, duke përfshirë proceset e filtrimit, filtrat me vakum, centrifuga, etj. Shpenzimet e para trashjes dhe rivendosja e copave të llumit në pikat në teren duhet të përfshihen poashtu.
Tharja me ajër e llumit	Shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtja rutinore me proceset e tharjes së llumit, duke përfshirë ngritjen e copave të llumit dhe rivendosjen e tyre në një pikë në teren.
Djegia	Operimi dhe mirëmbajtja rutinore e djegies së llumit, shpenzimet e tëra para trajtimit (duke përfshirë largimin e ujit në mënyrë mekanike) dhe rivendosja e hirit në terren.
Llumi i dërguar në rezervuar	Operimi dhe mirëmbajtja rutinore e të gjitha aktiviteteve të shoqëruara me largimin e llumit të stabilizuar nga pika e grumbullimit në vendin e fundit të trajtimit, duke përfshirë shpenzimet e ndërmjetme të deponimit.
Lumi i pompuar në tokë	Operimi dhe mirëmbajtja rutinore e pompimit të llumit të stabilizuar në tokë duke përfshirë koston e pompimit dhe punët në teren, etj.
Lumi në tokë përmes injektimit të dheut	Operimi dhe mirëmbajtja rutinore e të gjitha aktiviteteve të shoqëruara me shkarkimin e llumit në tokë me anë të injektimit të dheut nga pika e grumbullimit deri në vendin e fundit të vendosjes.
Shkarkimi i copave të llumit	Operimi dhe mirëmbajtja rutinore të shoqëruara me transportimin dhe ri-distribucionin e llumit nga pika e grumbullimit deri në vendin e fundit të vendosjes, për të përfshirë shpenzimet e mirëmbajtjes dhe shpenzimet tjera.
Llumi i dërguar në deponi	Shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes rutinore të shoqëruara me largimin e llumit të stabilizuar nga pika e grumbullimit deri në deponi, duke përfshirë pagesën e hyrjes dhe taksat.
Bartja e llumit në gypat e ujërave të zeza dhe punët tjera	Shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes rutinore të bartjes së llumit nga pika e prejardhjes deri në gypat e ujërave të zeza dhe punët tjera me anë të pompimit, rezervuarëve dhe mjeteve tjera para shkarkimit në pikën e pranimit.
Metodat tjera të shkarkimit të llumit	Shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes rutinore e të gjitha aktiviteteve të shoqëruara me trajtimin dhe shkarkimin e llumit me metoda tjera, duke përfshirë kompostimin, grosifikimin, pirolozës, silvikulturës dhe pylltarisë.
Administrimi, mbikëqyrja dhe menaxhimi	Të gjitha shpenzimet direkte të administrimit, mbikëqyrjes dhe menaxhimit duhet të identifikohen dhe alokohen në këtë nën aktivitet sipas nevojës.

Aktivitetet biznesore

Shërbimi me konsumatorë

Zërat që duhet të përfshihen	Përshkrimi
Llogari-mbajtjet për konsumatorët	Llogari-mbajtjet për konsumatorët, duke përfshirë ndërlidhjen dhe korrespondencën; mirëmbajtjen dhe kontrollimin e të dhënave; dërgimin e dokumenteve të konsumatorëve; kontrollimi i të dhënave hyrëse dhe dalëse në sistem dhe parashikimi.
Leximi i ujëmatësve të konsumatorëve	Leximi i ujëmatësve plus mbikëqyrja dhe menaxhimi i leximit të ujëmatësve.
Të ndryshme	Faturime të ndryshme duke përfshirë mirëmbajtjen dhe kontrollimin e dokumenteve; dërgimin e dokumenteve të konsumatorëve; faturimin e pagesave nga fluktuimet në treg; mirëmbajtja e llogarive të kontrollit dhe parashikimi; pyetjet specifike të konsumatorëve. Shpenzimet e shoqëruara me inspektimet rutinore për pronat e zbrazëta.
Kontrolli i parasë kesh	Arkëtimi, pranimi dhe kontrollimi i remitencave.
Kthimi i borxheve	Totali i kostove të shoqëruara në mënyrë të drejtpërdrejtë me arkëtimin e të ardhurave të papaguara nga konsumatorët. Duhet të përfshihen shpenzimet e faturave të vërejtjeve dhe të kthimit të borxheve. Kostoja e arkëtimit të të ardhurave të papaguara për shërbimet e blera dhe të pagesave të provizuara palëve të treta të kontraktuara për shërbimin e faturimit duhet të përfshihet poashtu. Shpenzimet relevante duhet të përfshijnë shpenzimet e ballafaqimit me borxhe apo të ekipeve për arkëtim, shpenzimet e gjykatave dhe juridike dhe kostoja e shkyçjes.
Ndryshimet në tarifa	Opsionet, aplikimet dhe kërkesat duke përfshirë pyetjet nga konsumatorët për ndryshimin e tarifave.
Pyetjet rreth faturimit	Konsumatorët dhe pyetjet rreth çështjeve të provizionimit që rezultojnë nga hetimet në teren nga të punësuarit operativ dhe të faturimit. Administrimi dhe kontrollimi i ankesave të konsumatorëve duke përfshirë regjistrat e centralizuar të ankesave, monitorimi i zgjidhjes së ankesave dhe gjykimi se si duhet t'i plotësojë kompania nevojat e konsumatorëve. Shpenzimet e ballafaqimit me transferimet potenciale në tarifë të matura.
Administrimi, mbikëqyrja dhe menaxhimi	Të gjitha shpenzimet direkte të administratës, mbikëqyrjes dhe menaxhimit duhet të identifikohen dhe alokohen në këtë nën aktivitet sipas nevojës.

Shërbimet shkencore

Zërat që duhet të përfshihen	Përshkrimi
Ofrimi i shërbimeve operative dhe shkencore	Vlerësimi i kualitetit të burimit, trajtimit dhe dezinfektimit. Investigimet e performancës së fabrikës dhe ndikimet në sistemin e distribuimit në bazë të kualitetit dhe tërësisë. Rishqyrtimi i trajtimit të ujit dhe performanca e përmirësimit të punëve, rekomandimet dhe mënyra optimale e operimit dhe zgjidhjet e vështirësive operative dhe mosfunksionimeve. Shqyrtimet e problemeve të ujërave të zeza. Monitorimi i shkarkimit të llumit. Zhvillimi dhe implementimi i procedurave të sqarimit dhe vlerësimi i burimit të rrezikut. Formulimi dhe implementimi i monitorimit dhe programeve të marrjes së mostrave dhe interpretimet dhe raportimet në bazë të rezultateve për të plotësuar kërkesat e menaxhimit dhe sigurisë së shëndetit publik. Marrja e mostrave për qëllime operative. Vlerësimi i kapacitetit të punës dhe metodat e ngritjes së normave sipas nevojës. Këshillimet mbi procesin e përzgjedhjes dhe specifikave të fabrikës së re të trajtimit. Monitorimi dhe këshillimi mbi përdorimin e kemikaljeve në trajtimin e ujit dhe dezinfektimi, përmirësimi i ujit dhe trajtimi i llumit. Shqyrtimet e ankesave nga konsumatorët e amvisërisë dhe të industrisë dhe këshillimet për konsumatorët industrial (të bizneseve) mbi përdorimin e ujit. Ndërlidhja me autoritetet e shëndetësisë dhe mjedisit. Administrimi i të dhënave që kanë të bëjnë me mbështetjen shkencore. Këshillimet mbi shëndetin dhe sigurinë e personelit me referim të veçantë të menaxhimit të gazit të klorit dhe kemikaljeve tjera dhe në paraqitjen e atmosferës së rrezikshme.

Zërat që duhet të përfshihen	Përshkrimi
Ofrimi i shërbimeve laboratorike	Pranimi, regjistrimi dhe analizat kimike, biologjike dhe bakteriologjike të mostrave nga punët për përpunimin e ujit, trajtimi i ujit, lumenjtë, ujërat nëntokësore, shkarkimet industriale, rrjeti i distribuimit dhe rubinetat e konsumatorëve, llumi dhe dheu. Raportimi i rezultateve. Menaxhimi i të dhënave brenda laboratorit deri tek hartimi i raportit analitik. Këshillimet nga specialistet mbi interpretimin e rezultateve, në veçanti të të dhënave biologjike dhe bakteriologjike. Menaxhimi i pajisjeve të përdorura në analizat laboratorike dhe të monitorimit të kemikaljeve, sezonet dhe ndërhyrjet në terren. Ushtrimet e kontrollimit analitik të kualitetit. Matjet e performancës së laboratorit.
Rishqyrtimi i kualitetit	Mirëmbajtja e një shqyrtimi të pavarur dhe të vazhdueshëm të menaxhimit dhe operimit të përgjegjësive të Kompanisë për çështje të kualitetit të ujit, duke përfshirë burimet e ujit dhe furnizimet, lumenjtë dhe ujërat tokësor, ujërat e zeza dhe shkarkimi i tyre në gypa, ujërat e zeza dhe shkarkimi i tyre në lumenj dhe det, dhe llumi. Ekzaminimet e standardeve të kualitetit dhe normave të pajtuara; praktikatat dhe procedurat për të siguruar pajtueshmërinë me standarde dhe sisteme për menaxhimin e ankesave të konsumatorëve dhe ankesat e tjera publike në lidhje me kualitetin; rishikimi i emergjencave dhe incidenteve të cilat kanë ndikuar në kualitet.
Administrimi, mbikëqyrja dhe menaxhimi	Të gjitha shpenzimet direkte të administrimit, mbikëqyrjes dhe menaxhimit duhet të identifikohen dhe të alokohen në këtë nën aktivitet sipas nevojës.

Shpenzimet rregullatore

Zërat që duhet të përfshihen	Përshkrimi
Gjenerale	Koordinimi dhe mbikëqyrja e ndërlidhjes me organet e rregullatorit.
Tarifat e licencave	Tarifat e licencave të cilat i paguhen ZRRUM në bazë të rregullores.
Tarifat e certifikimit	Tarifat e certifikimit (duke përfshirë revidimin) të ngarkuara si rezultat i kërkesave të licencimit.
Shërbimet shkencore	Dorëzimi në dhe ndërlidhja me organet tjera rregullatore mbi çështjet që ndërlidhen me kualitetin e ujit, nivelin e nxjerrjes, kualitetin e rrjedhës dhe standardet e pëlqimit.
Kontabiliteti rregullator	Shpenzimet në rritje e sipër që lidhen me përgatitjen e kontabilitetit rregullator.
Kthimet	Përgatitja dhe dorëzimet e kthimeve në ZRRUM.
Plani për menaxhim të aseteve	Shpenzimet në rritje e sipër të ndërlidhura me zhvillimin e planit për menaxhim të aseteve.
Rishqyrtimi i tarifave	Shpenzimet menaxheriale në rritje e sipër në lidhje me rishikimin e tarifave.

Aktivitet e përgjithshme dhe mbështetëse

Zërat që duhet të përfshihen	Përshkrimi
Ofrimi i shërbimeve administrative	Ofrimi i administrimit të përgjithshëm, shtypjet, sekretariati, asistenca personale, shërbimet e nëpunësve, duke përfshirë administrimin dhe përvetësimin e pajisjeve të materialit dhe shërbimeve.
Shërbimet e personelit	Marrëdhëniet industriale, punësimi, përzgjedhja dhe ndërprerja e kontratës, sistemi i informacioneve të fuqisë punëtore, mirëqenia, detyrat e përgjithshme të personelit, administrimi i skemave të punëtorëve, administrimi dhe ofrimi i shërbimeve të trajnimit.
Shërbimet e menaxhimit	Skemat e prodhimitarise, kontrollimi strukturor, shëndeti dhe siguria, shërbimet këshillimore dhe premisat e bufese.
Shërbimet financiare	Kontabiliteti i financave dhe menaxhimit dhe përgatitja e buxhetit, provizionimi i administrimit të pagave, administrimi i kreditorëve, administrimi i sigurimit, shërbimet financiare, përcaktimi i politikave të provizionimeve dhe implementimi dhe caktimi i tarifave fikse.
Shërbimet juridike dhe për menaxhim të pasurisë	Çështjet ligjore në lidhje me blerjen dhe shitjen e pasurisë së tokës (duke përfshirë përcaktimin e pronësisë dhe banorët e tokës të ndikuar nga skemat kapitale); lëshimi me qira i tokës dhe zyrave të kompanisë; lejimi i lehtësirave (dhe përgatitja e regjistrave të kushteve të tokës para hyrjes) nga dhe për Kompani; marrëveshjet e qiramarrjes; licencat; çështjet e qiramarrjes; licencat; çështjet e autostradës; regjistrat e pronës dhe biblioteka juridike; marrëveshjet me zhvilluesit. Kontestet juridike dhe çështjet tjera juridike duke përfshirë hartimin kontratave dhe këshillimet mbi heshtjet kontraktore; ndjekjet penale nga Kompania; mbrojtja e Kompanisë në ndjekjet penale të iniciuara nga organet e jashtme/personat, padite civile duke përfshirë kthimin borxheve; arbitrimet dhe këshillimet në lidhje me paditë kontraktore dhe paditë për kompensim që vijnë nga punët publike. Këshillime mbi përgjegjësitë e Kompanisë sipas legjislacionit

Zërat që duhet të përfshihen	Përshkrimi
Hulumtimet dhe zhvillimi	Koordinimi dhe ofrimi i hulumtimeve dhe zhvillimi
Përcaktimi i politikave, implementimi dhe monitorimi	Koordinimi i objektivave të planifikimit afatgjatë/afatë mesëm duke përfshirë; formulimin e politikave, zhvillimin e strategjisë/planifikimin, rishqyrtimet e parashikimeve të kërkesave/analizat, menaxhimi i bazës së të dhënave, strategjitë kapitale dhe implementimi.
Shërbimet e auditimit	Shërbimet e revidimit financiar dhe teknik
Shërbimet e marrëdhënieve me publikun dhe personelin	Shërbimet e marrëdhënieve me publikun dhe shërbimet për informacionet e personelit
Automjetet dhe paisjet	Menaxhimi i automjeteve, mirëmbajtjes dhe shpenzimet qarkulluese, garazhet, etj.
Deponimi i materialeve	Deponimi i materialeve/kontrollimi i depos, objektet e deponimeve, zyret dhe objektet e tjera të përgjithshme dhe mbështetëse, shërbimet e pastrimit.

SHTOJCA 6 – KLASIFIKIMI I SHPENZIMEVE KAPITALE SIPAS LLOJIT TË ASETEVE DHE QËLLIMIT

Kjo skemë paraqet klasifikimin e investimeve kapitale në mes të aseteve infrastrukturore dhe jo-infrastrukturore sipas qëllimit, ose shërbimit bazë apo të kualitetit të përmirësuar. Kategoritë e ngritjes së shërbimeve të 'niveleve të ngritura të shërbimeve' (NNSH) dhe 'bilanci furnizim/kërkesë' (BFK) mund të aplikohen përgjatë të gjitha kategorive.

Fushat e shërbimit të furnizimit me ujë

Objektet e resurseve të ujit
Punët e trajtimit të ujit
Gypat e distribuimit të ujit
Rezervuarët e shërbimit dhe shtyllat e ujit
Stacionet e pompave shtytëse
Menaxhimi dhe të përgjithshme - shërbimet e furnizimit me ujë

Fushat e shërbimit të ujërave të zeza

Grumbullimi i Ujërave të Zeza
Punët kryesore
Punët e trajtimit të ujërave të zeza
Trajtimi i llumit
Shkarkimi i llumit
Stacionet e pompimit
Stacionet terminale të pompimit
Menaxhimi dhe të përgjithshme – shërbimet e ujërave të zeza

Infrastrukturore apo jo-infrastrukturore	Shërbimet e furnizimit të ujit – të gjitha fushat	Qëllimet e shpenzimeve
Infra apo Jo-infra	Elementi i punëve vetëm për të arritë përmirësime të identifikueshme, të matshme dhe të përhershme në nivelin e shërbimeve mbi nivelin e shërbimeve bazë të themeluar së fundi.	NNSH
Infra apo Jo-infra	Elementi i punëve të kërkuara vetëm për të plotësuar kërkesën nga konsumatorët e ri dhe/apo kërkesës së rritur nga konsumatorët ekzistues.	BFK

Infrastrukturore apo jo-infrastrukturore	Objektet e resurseve të ujit	Qëllimet e shpenzimeve
	Të gjitha pendat dhe rezervuarët të cilët ruajnë ujin e papërpunuar, të gjitha stacionet e pompave në sistemet e ujit të papërpunuar duke përfshirë pompat për bartjen e ujit, derdhjet në lumenj, pusët të cilat kërkojnë dezinfektim të thjeshtë para hyrjes në sistem të furnizimit, dhe të gjitha gypat dhe akuaduktet të shoqëruara me bartjen e ujit të papërpunuar ose në mes të burimeve ose prej burimit në trajtim.	
	ZHVILLIMI I RESURSEVE	
Jo-infra	Përtritjet e puseve, derdhjeve në lumenj dhe objektet e ngjashme	Bazë
	MIRËMBAJTJA E RESERVARËVE DUKE PËRFSHIRË SIGURINË	
Infra	Raportimi dhe përtritja e pendave, zgjerimi i gjatësisë së murit të pendës, zgjerimi i rrugës së derdhjes, punët rehabilituese.	Bazë
	STACIONET E POMPAVE	
Jo-infra	Të reja/përtritje/punë tjera deri në stacione të pompave për elementin e madhësisë dhe/apo racionalizimin	Bazë
	PËRTRITJE E AKUADUKTEVE	
Infra	Madhësia për masën /ekuivalentin metrik të ndërrimeve të gypave pavarësisht prej materialit.	Bazë
Infra	Metalizimi dhe mbështjelljet /ri-mbështjelljet për tu qasur kushteve/shtypjes/rrjedhjes/problemeve të ndërprerjes.	Bazë
Infra	Ri-mbështjellja vetëm për arsye të ujit të furnizuar për t'i plotësuar kushtet e BE-së apo Rregullores për Kualitetin e Ujit në Kosovë dhe duke rezultuar me gyp i cili është i aftë për të furnizuar me ujë të standardit të ngritur. Shënim: Metalizimi dhe mbështjellja janë mirëmbajtje prandaj edhe janë bazë.	Kualitet
Infra	Ruajtja e përgjithshme e rrjetit duke përfshirë pastrimin, zëvendësimin e gypit të pëlcitur dhe hetimin e kushteve të akuaduktëve.	Bazë
Infra	Përtritjet/ndërrimet e urave të gypave, tuneleve, kanaleve, valvuleve dhe pusetave.	Bazë
Infra	Punët për të siguruar/ofruar furnizime alternative në mënyrë që të mirëmbahet provizionimi i shërbimeve bazë.	Bazë
Infra	Madhësia për masën e devijimeve.	Bazë
	GJENERALE	
Infra	Punët për të respektuar legjislacionin për shëndet dhe siguri:	Bazë
Jo-infra	- nën tokë	
	- mbi tokë	
Infra	Punët për të përmirësuar eficiencën, p.sh. kursimin e energjisë:	Bazë
Jo-infra	- nën tokë;	
	- mbi tokë.	

Infrastrukturore apo jo-infrastrukturore	Punët për trajtimin e ujit	Qëllimet e shpenzimeve
Jo-infra	Të gjitha punët e trajtimit të ujit, por duke përjashtuar dezinfektimin e thjeshtë të shoqëruar me pusët nën tokë dhe gjithashtu dezinfektimin sekondar të përfshirë me sistemin e distributimit.	
Jo-infra	Elementi madhësi për madhësi/objektet e ngritura të trajtimit, përmirësimet e punëve ekzistuese duke përfshirë kontrollimin e instrumenteve dhe automatizimin.	Bazë
Jo-infra	Kontrollimet e reja instrumentale dhe të automatizimit për të përmirësuar eficiencën operative edhe nëse e përmirëson kualitetin trajtimit.	Bazë
Jo-infra	Elementi i objekteve shtesë/të ngritura të trajtimit vetëm për të u pajtuar me obligimet e kualitetit ligjor për kapacitetin e punëve aktuale dhe rezultimi me punë të trajtimit të afta për të furnizuar ujë sipas standardeve me kualitet të lartë.	Kualitet
Jo-infra	Punët për të respektuar legjislacionin e shëndetit dhe sigurisë.	Bazë
Jo-infra	Punët për të përmirësuar eficiencën, p.sh. kursimin e energjisë.	Bazë

Infrastrukturore apo jo-infrastrukturore	Gypat për distribuimin e ujit	Qëllimet e shpenzimeve
	Të gjitha gypat e shoqëruar me furnizimin e ujit për konsumatorët e amvisërisë dhe të bizneseve duke përfshirë urat e gypave, tunelet, tunelet e shërbimit, kanalet nën rrugë, valvulat, pusët dhe ndihmësit e sistemit.	
	GYPAT	Bazë
	Devijimet, duplikimet, të reja, mbështjellja e gypave, ndërrimi, përforsimi, mbështjellja me metale dhe linjëzimi:	
Infra	- elementi madhësi për masë/ekuivalentin metrik, pavarësisht prej materialit për të mirëmbajtje ofrimin e shërbimeve bazë;	Bazë
Infra	- elemente që vijnë nga nevoja për kapacitet aktual, për të respektuar detyrimet ligjore të kualitetit	Kualitet
Infra	Përtritjet e urave të gypave, tuneleve, gypave nën rrugë, valvulave dhe pusëve.	Bazë
	RRETH KONSUMATORËVE	
Jo-infra	Përtritjet e matësve të rrjedhës/shtypjes dhe pusëve.	Bazë
Infra	Përtritjet /ngritjet e gypave të komunikimit/shërbimit :	Bazë
	PUNË TJERA	
Infra	Hetimet zonale.	Bazë
Jo-infra	Monitorimi i shtypjes dhe rrjedhjes (përfsh. Logerët portativ)	Bazë
Jo-infra	Dezinfektimi sekondar.	Bazë
	Punët për të respektuar legjislacionin për shëndet dhe siguri:	Bazë
Infra	- nën tokë	
Jo-infra	- mbi tokë	
	Punët për të përmirësuar eficiencën, p.sh. kursimi i energjisë	Bazë
Infra	- nën tokë	
Jo-infra	- mbi tokë	

Infrastrukturore apo jo-infrastrukturore	Rezervuarët e shërbimit dhe shtyllat e ujit	Qëllimet e shpenzimeve
Jo-infra	Të gjithë rezervuarët e ujit të trajtuar dhe shtyllat brenda sistemit të furnizimit me ujë dhe punët për trajtimin e ujit dhe dezinfektimi sekondar dhe vendet e rezervuarëve. Përfshihen rezervuarët për pushimin e shtypjes.	Bazë
Jo-infra	Përritjet e punëve tjera të rezervuarëve dhe shtyllave të ujit.	Bazë
Jo-infra	Punët për të respektuar legjislacionin e shëndetit dhe sigurisë.	Bazë
Jo-infra	Punët për të përmirësuar eficiencën , p.sh. kursimin e energjisë.	Bazë

Infrastrukturore apo jo-infrastrukturore	Stacionet e pompave –uji i trajtuar	Qëllimet e shpenzimeve
Jo-infra	Stacionet e pompave që vijnë nga deponimi i ujit të trajtuar. Shënim: Stacionet e pompave në sistemet e ujit të papërpunuar janë të përfshira nën Objektet e Resurseve të Ujit dhe stacionet ndër fazore të pompave të punët për trajtimin e ujit nën Trajtimin e Ujit.	Bazë
Jo-infra	Të reja/përritje/ i punëve tjera në stacionet e pompave elementi madhësi për madhësi dhe/apo racionalizimi.	Bazë
Jo-infra	Punët për të respektuar legjislacionin e shëndetit dhe sigurisë.	Bazë
Jo-infra	Punët për të përmirësuar eficiencën, p.sh. kursimin e energjisë	Bazë

Infrastrukturore apo jo-infrastrukturore	Menaxhimi dhe të përgjithshme – shërbimi i ujit	Qëllimet e shpenzimeve
Infra	Hartimi i hartave dhe përditësimi i të dhënave të rrjetit dhe përritjet e ndërlidhura të eficiencës.	Bazë
Jo-infra	Të reja/zgjerimet e pronës ekzistuese, objektet, laboratorët, depot dhe punëtoritë.	Bazë
Jo-infra	Të reja /përritjet e telemetrisë/sistemeve të komunikimit/pajisjet e monitorimit, marrja e mostrave dhe pajisjet, prona, objektet, laboratorët, depot dhe punëtoritë.	Bazë
Jo-infra	Të reja /përritjet e kompjuterëve (duke përfshirë softuerin), automjetet dhe pajisjet lëvizëse.	Bazë
Jo-infra	Rekreacioni/kursimi.	Bazë
Jo-infra	Siguria në terren.	Bazë
Jo-infra	Punët për të respektuar legjislacionin e shëndetit dhe sigurisë.	Bazë
Jo-infra	Punët për të përmirësuar eficiencën, p.sh kursimin e energjisë	Bazë

Infrastrukturore apo jo-infrastrukturore	Shërbimet e ujërave të zeza – të gjitha fushat	Qëllimet e shpenzimeve
Infra ose jo-infra	Elementi i punëve vetëm për të arritë përtritjet e identifikueshme, të matshme dhe të përhershme të nivelit të shërbimit mbi nivelin e shërbimit të themeluar së fundi.	NNSH
Infra ose jo-infra	Elementi i punëve të kërkuara vetëm për të plotësuar kërkesën nga konsumatorët e ri dhe/apo kërkesës së rritur nga konsumatorët ekzistues.	BFK

Infrastrukturore apo jo-infrastrukturore	Grumbullimi i Ujërave të Zeza	Qëllimet e shpenzimeve
	Tërë uji i papërpunuar, kombinuar, uji relevant mbitokësor dhe gypat e ujërave të zeza duke përfshirë gypat interceptor, pusetat, mbi rrjedhjet, gypat për pompimin e ujërave të zeza, sifonet, rezervuarët dhe gypat për bartjen e ujërave të zeza. Devijimet/duplikimet/ të reja/përtritjet/ndërrimet e gypave të ujërave të zeza, gypave interceptor, vërshimet nga stuhitë, kapaciteti i deponimit dhe kapakët e pusetave, hetimet e fushës së kanalizimit duke përfshirë rrjedhjet e ujit dhe ngritjet e marrjes së të dhënave specifike.	
Infra	- madhësi për madhësi/elementi i madhësisë ekuivalente metrike, racionalizimi;	Bazë
Infra	- elementi vetëm për të përmirësuar mbi rrjedhjet e pakënaqshme apo për të plotësuar kërkesat e rregulloreve të reja.	Kualiteti
Infra	Punët për të respektuar legjislacionin e shëndetit dhe sigurisë.	Bazë
Infra	Punët për të përmirësuar eficienten, p.sh. kursimin e energjisë	Bazë

Infrastrukturore apo jo-infrastrukturore	Punët kryesore	Qëllimet e shpenzimeve
Jo-infra	Përtritje/rehabilitimi/elementi madhësi për madhësi të punëve tjera /racionalizimi;	Bazë
Jo-infra	Elementet e kërkuara vetëm për të plotësuar kërkesat apo detyrimet ligjore të kualitetit në punët kryesore të kapacitetit aktual të aftë për të trajtuar ujërat e zeza sipas standardeve të kërkuara.	Kualiteti
Jo-infra	Përtritjet /kontrollimet e reja të instrumenteve dhe automatizimi edhe nëse e përmirëson kualitetin e trajtimit.	Bazë
	Punët për të respektuar legjislacionin e shëndetit dhe sigurisë	Bazë
Infra	- nën tokë;	
Jo-infra	- mbi tokë.	
	Punët për të përmirësuar eficienten, p.sh. kursimin e energjisë	Bazë
Infra	- nën tokë;	
Jo-infra	- mbi tokë.	

Infrastrukturore apo jo-infrastrukturore	Punët për trajtimin e Ujërave të Zeza	Qëllimet e shpenzimeve
	Përfshijnë të gjitha punët e trajtimit të ujërave të zeza me një apo me shumë faza të trajtimit, stacionet e pompave ndër-fazore dhe rezervuarët për mbajtjen e llumit me provizionim të largimit të ujit.	
Jo-infra	Punët e reja të trajtimit/punët e kryera kundrejt punëve ekzistuese për të ngritur kapacitetin e trajtimit.	Bazë
Jo-infra	- elementi madhësi për madhësi dhe racionalizimi;	Kualiteti
Jo-infra	- elementi i kërkuar vetëm për të plotësuar kushtet ligjore të kualitetit	Bazë
	Kontrollimet e instrumenteve të reja dhe automatizmit për të përmirësuar kualitetin e efikasitetit operative edhe nëse e përmirëson kualitetin e trajtimit, përmirësimin e punëve ekzistuese të trajtimit dhe kontrollimin e instrumenteve dhe automatizimit e elementit madhësi për madhësi të punëve tjera të kryera kundrejt punëve ekzistuese për të përmirësuar kapacitetin e trajtimit.	
Jo-infra	Punët për të respektuar legjislacionin e shëndetit dhe sigurisë.	Bazë
Jo-infra	Punët për të përmirësuar efikasitetin, p.sh. kursimin e energjisë.	Bazë

Infrastrukturore apo jo-infrastrukturore	Trajtimi i llumit	Qëllimet e shpenzimeve
	Të gjitha punët për trajtimin e llumit të cilat e ndryshojnë natyrën e llumit të papërpunuar para shkarkimit final. Rezervuarët për mbajtjen e llumit janë të përfshira tek Punët për Trajtimin e Ujërave të Zeza.	
	Të reja/trajtimi i përthitur /objektet e deponimit, përmirësimi i punëve ekzistuese të trajtimit, stacionet e pompave.	
Jo-infra	- elementi madhësi për madhësi dhe racionalizimi;	Bazë
Jo-infra	- elementi i kërkuar vetëm për të plotësuar kushtet ligjore të kualitetit element ose të disponueshmërisë së nivelit ekzistues të llumit ose për nivelet e ngritura të llumit të cilat rezultojnë nga me shumë standarde të kualitetit të rrjedhjeve.	Kualiteti
Jo-infra	Kontrollimet e instrumenteve të reja dhe automatizmit për të përmirësuar kualitetin e efikasitetit operative edhe nëse e përmirëson kualitetin e trajtimit.	Bazë
Jo-infra	Punët për të respektuar legjislacionin e shëndetit dhe sigurisë.	Bazë
Jo-infra	Punët për të përmirësuar efikasitetin, p.sh. kursimin e energjisë.	Bazë

Infrastrukturore apo jo-infrastrukturore	Derdhja e llumit (duke përjashtuar automjetet)	Qëllimet e shpenzimeve
	Përfshijnë të gjitha mjetet dhe rregullimet e bartjes të ndërlidhura me disponueshmërinë përfundimtare të llumit të trajtuar. Automjetet për shkarkimin e llumit janë të përfshira tek Menaxhimi dhe Punët e Përgjithshme.	
Infra	Mirëmbajtja e gypave të ujërave të zeza.	Bazë
Jo-infra	Mirëmbajtja e punëve kryesore ekzistuese, impianti për shkarkimin e llumit.	Bazë
	Punët për të respektuar legjislacionin e shëndetit dhe sigurisë	Bazë
Infra	- nën tokë;	
Jo-infra	- mbi tokë.	
	Punët për të përmirësuar efikasitetin, p.sh. kursimin e energjisë	Bazë
Infra	- nën tokë;	
Jo-infra	- mbi tokë.	

Infrastrukturore apo jo-infrastrukturore	Stacionet e pompave	Qëllimet e shpenzimeve
Jo-infra	Të gjitha stacionet e pompave të ndërlidhura me sistemin e ujërave të zeza dhe stacionet terminale të pompave.	Bazë
Jo-infra	Përtrritjet /racionalizimet e strukturave të pajisjeve mekanike, elektrike dhe telemetrike.	Bazë
Jo-infra	Punët për të respektuar legjislacionin e shëndetit dhe sigurisë.	Bazë
Jo-infra	Punët për të përmirësuar eficiencën, p.sh. kursimin e energjisë	Bazë

Infrastrukturore apo jo-infrastrukturore	Menaxhimi dhe Punët e Përgjithshme – shërbimet e grumbullimit të ujërave të zeza	Qëllimet e shpenzimeve
Infra	Hartimi i hartave dhe përditësimi i të dhënave të rrjetit dhe përmirësimet e ndërlidhura të eficiencës.	Bazë
Jo-infra	Të reja/zgjerimet e pronës ekzistuese, objektet, laboratorët, depot dhe punëtoritë.	Bazë
Jo-infra	Të reja/përtrritjet e sistemeve telemetrik/të komunikimit, kontrollimi i rrjedhjeve, marrja e mostrave dhe pajisjet, toka, objektet, depot dhe punëtoritë.	Bazë
Jo-infra	Të reja/përtrritjet e kompjuterëve (duke e përfshirë softuerin), automjetet dhe pajisjet lëvizëse.	Bazë
Jo-infra	Rekreative/kursimi.	Bazë
Jo-infra	Siguria në terren.	Bazë
Jo-infra	Punët për të respektuar legjislacionin e shëndetit dhe sigurisë.	Bazë
jo-infra	Punët për të përmirësuar eficiencën, p.sh. kursimin e energjisë	Bazë